

## Shëlbuesi i Njëriut



## Shën Gjon Pali II

Letra encicklike “*Redemptor hominis*”

(1979)

Përkthimi në gjuhën shqipe nën kujdes të

dom C. Lorenzo Rossetti

Me rastin e 40 vjetorit

Falenderohen Jonilda Lemezhi e Mr. Judita Marku

Shkodër 2019

Në kopertinë: El Greco, *Salvator mundi*

LETËR ENCIKLIKE

“**REDEMPTOR HOMINIS**”

**E PAPËS GJON PALI II**

VËLLEZËRVE TË NDERUAR TË EPISKOPATIT  
MESHTARËVE DHE FAMILJEVE RREGULTARE  
BIJVE DHE BIJAVE TË KISHËS  
DHE TË GJITHË NJERËZVE VULLNETMIRË  
NË FILLIM TË SHËRBESËS SË TIJ PAPNORE

4 mars 1979

Shkodër 2019

Përmbajtja

## **I - Trashëgimi**

- 1. Në mbarimin e mijëvjeçarit të dytë**
- 2. Fjalët e para të Papatit të ri**
- 3. Besim në Shpirtin e së Vërtetës dhe të Dashurisë**
- 4. Referencë ndaj Enciklikës së parë të Palit VI**
- 5. Kolegjialitet dhe apostullim**
- 6. Rruga e bashkimit të të krishterëve**

## **II- Misteri i shëlbimit**

- 7. Në misterin e Krishtit**
- 8. Shëlbimi: Krijim i ripërtërirë**
- 9. Dimension i hyjnor i misterit të Shëlbimit**
- 10. Dimension i njerëzor i misterit të Shëlbimit**
- 11. Misteri i Krishtit, themeli i misionit të Kishës**
- 12. Misioni i Kishës dhe liria e njeriut**

## **III- Njeriu i shëlbuar dhe situata e tij në botën bashkëkohore**

- 13. Krishti është bashkuar me çdo njeri**
- 14. Të gjitha rrugët e Kishës çojnë tek njeriu**
- 15. Nga çfarë ka frikë njeriu bashkëkohor?**
- 16. Përparimi apo kërcënimi?**
- 17. Të drejtat e njeriut: «shkronjë» apo «shpirt»**

## **IV- Misioni i Kishës dhe fati i njeriut**

- 18. Kisha kujdeset për thirrjen e njeriut në Krishtin**
- 19. Misioni profetik: Kisha përgjegjëse për të vërtetën**
- 20. Misioni priftëror: Shenjtëria e njeriut, Eukaristia dhe pendesa**
- 21. Misioni mbretëror: Thirrja e krishterë për shërbim**
- 22. Maria Nëna e besimit tonë**

## I – Trashëgimi

Të nderuar Vëllezër dhe Bijë të dashur, shëndet dhe Bekim Apostolik!

### 1. Në mbarimin e mijëvjeçarit të dytë

Shëlbuesi i njeriut, Jezu Krishti, është qendra e kozmosit dhe e historisë. Atij i drejtohen mendimet e mija dhe zemra ime në këtë orë solemne, që Kisha dhe mbarë familja e njerëzimit bashkëkohor po përjeton. Në fakt, kjo kohë, në të cilën Hyji me planin e Tij misterioz, pas Paraardhësit të dashur Gjon Pali I, më ka besuar shërbimin universal të lidhur me Katedrën e Shën Pjetrit në Romë, është tashmë shumë afër vitit 2000. Është e vështirë të thuhet në këtë moment, se çfarë do të shënojë ai vit në kuadrin e shoqërisë njerëzore, dhe si do jetë ky vit për secilin popull, komb, vend apo kontinent, edhe pse që tani përpiqet të parashikohet ndonjë event. Për Kishën, për Popullin e Zotit, që është përhapur -qoftë edhe në mënyrë të pabarabartë- deri në kufijtë më të largët tokësorë, ai vit do jetë viti i një Jubileu të madh. Po i afrohem tashmë një date të tillë që, -duke respektuar të gjitha korrigjimet rreth saktësisë kronologjike- do të na kujtojë, dhe në mënyrë të veçantë do të na ripërtërijë vetëdijen e së vërtetës kyçe të besimit, e shprehur nga Shën Gjoni në fillimet e Ungjillit të tij: «*E Fjala u bë njeri dhe banoi ndër ne*»<sup>1</sup>, e diku tjetër: «*Vërtet, Hyji aq fort e deshi botën, sa që dha një të vetmin Birin e vet kështu që, secili që beson në të, të mos birret, por ta ketë jetën e pasosur*»<sup>2</sup>.

Jemi edhe ne, në një farë mënyre, në kohën e një Ardhjeje të re, që është kohë pritjeje. «Mbas Hyji herë mbas here dhe në mënyra të ndryshme, në të kaluarën, u ka folur etërve me anë të profetëve, së fundi, në këto ditë, na foli edhe neve me anë të Birit ...»<sup>3</sup>, nëpërmjet Birit-Fjalë që u bë njeri dhe u lind nga Virgjëra Mari. Në këtë akt shpëtimi, historia e njeriut ka arritur majën në planin e dashurisë së Hyjit. Hyji ka hyrë në historinë e njerëzimit dhe, si njeri, është bërë “subjekti” i tij, një në një miliard, dhe në të njëjtën kohë, Unik! Përmes Mishërimit, Hyji i ka dhënë jetës njerëzore atë dimension që synonte t’i jepte qysh prej fillimi, dhe ia ka dhënë në mënyrë përfundimtare, në mënyrën e Tij të veçantë, sipas dashurisë së Tij të përjetshme dhe Mëshirës së Tij, me gjithë lirinë hyjnore, dhe bashkë me atë bujarinë e madhe që, përballë mëkatit origjinal dhe gjithë historisë së mëkateve të njerëzimit, përballë gabimeve të intelektit, të vullnetit dhe të zemrës njerëzore, na lejon të përsërisim me habi fjalët e Liturgjisë së shenjtë: «o i lumi faji, që meritoi ta kishte një Shëlbues të tillë dhe aq të madh»<sup>4</sup>.

### 2. Fjalët e para të Papatit të ri

Drejt Krishtit Shpëtimtar i kam drejtuar ndjenjat dhe mendimet e mija me 16 tetor të vitit të kaluar, atëherë kur pas zgjedhjes kanonike, mu drejtua pyetja: «Pranon?». U përgjigja: «Duke iu bindur Krishtit, Zotit tim në fe, duke iu besuar nënës së Krishtit dhe Kishës, pranoj». Këtë përgjigje timen dua ta bëj sot të njohur publikisht për të gjithë, pa asnjë përjashtim, duke demonstruar kështu që me të vërtetën e parë dhe themelore të Mishërimit, të përmendur më lart, është i lidhur mbarështimin që, me pranimin e zgjedhjes si Ipeshkëv i Romës dhe si Pasardhës i Apostullit Pjetër, është bërë detyra ime specifike në Katedrën e tij.

Zgjedhja të njëjtat emra, që kishte zgjedhur Paraardhësi im i dashur Gjon Pali I. Në fakt, që me 26 gusht 1978, kur ai deklaroi në Kolegjin e Shenjtë që donte të quhej Gjon Pali- një emër të këtij lloji nuk kishte patur ndonjëherë në historinë e Papatit- pashë në të një dëshirë të qartë të hirit të papatit të ri. Duke qenë se ai papat ka zgjatur vetëm 33 ditë, më takon mua jo vetëm ta vazhdoj, por, në një farë mënyre, ta marr nga e njëjta pikë nisje. Kjo është konfirmuar kontretisht nga zgjedhja që unë kam bërë, e atyre dy emrave. Duke i zgjedhur, pas shembullit të Paraardhësit tim të nderuar, dëshiroj, ashtu si ai, të shpreh dashurinë time për trashëgiminë e vetme të lënë Kishës nga Papët Gjoni XXIII dhe Pali VI, dhe bashkë me gatishmërinë time personale, ta zhvilloj me ndihmën e Hyjit.

Me anë të këtyre dy emrave dhe dy papateve i referohem të gjithë traditës së kësaj Selie Apostolike, me të gjithë Paraardhësit e shekullit XX dhe të shekujve të mëparshëm, duke u lidhur me radhë, sipas moshave të

ndryshme deri te më të lashtat, me atë drejtimin e misionit të mbarështimit, që i jep Selisë së Pjetrit, një vend krejt të veçantë në Kishë.

Gjoni XXIII dhe Pali VI përbëjnë një etapë, të cilës dua t'i referohem direkt si fillim, nga e cila nënkuptoj, në një farë mënyre bashkë me Gjon Palin I, të vazhdoj drejt së ardhmes, duke e lënë veten të udhëhiqem nga besimi i pa kufi dhe nga bindja ndaj Shpirtit, që Krishti i ka premtuar dhe dhënë Kishës së Tij. Ai iu thoshte, në fakt, Apostujve në prag të pasionit të tij: «*Por, unë po ju them të vërtetën: është më mirë për ju të shkoj, sepse, po s' shkova, Mbrojtësi nuk do të vijë te ju, kurse po shkova, do ta dërgoj te ju*»<sup>5</sup>. «*E kur të vijë Mbrojtësi, të cilin do t'ju dërgoj prej Atit -Shpirti i së Vërtetës, që rrjedh prej Atit- Ai do të dëshmojë për mua. Por edhe ju gjithashtu do të dëshmoni për mua, sepse jeni me mua që në fillim*»<sup>6</sup>. «*E kur të vijë Ai -Shpirti i së Vërtetës- Ai do t'ju udhëzojë ta njihni tërë të Vërtetën. Ai s' do të flasë prej vetvetes, por do të flasë çka të dëgjojë dhe do t'ju zbulojë të ardhmen*»<sup>7</sup>.

### 3. Besim në Shpirtin e së Vërtetës dhe të Dashurisë

Duke iu besuar plotësisht Shpirtit të së vërtetës, hyra pra në trashëgiminë e pasur të papatëve të kohëve të fundit. Kjo trashëgimi është e rrënjësor fort në ndërgjegjen e Kishës në një mënyrë krejtësisht të re, të panjohur kurrë më parë, falë Koncilit të Vatikanit II, i thirrur dhe i inaguruar nga Gjoni XXIII, dhe më tej, i përfunduar me gëzim dhe zbatuar me këmbëngulje nga Pali VI, aktivitetin e të cilit kam mundur ta shoh vetë nga afër. Gjithmonë kam mbetur i habitur nga zgjuarsia e tij e madhe dhe nga kurajo e tij, ashtu si dhe nga qëndrueshmëria dhe durimi në periudhën e vështirë pas-Koncilit të papatit të tij. Si drejtues i Kishës, barkës së Pjetrit, ai dinte të ruante një qetësi dhe një ekuilibër providencial edhe në momentet më kritike, kur dukej se ishte një tronditje nga brenda, duke e mbajtur gjithmonë të patundur shpresën në kompaktësinë e saj. Në fakt, ajo që Shpirti i thotë Kishës me anë të Koncilit të kohëve tona, ajo që në këtë Kishë i thotë të gjitha Kishave<sup>8</sup> nuk mund të shërbejë për asgjë tjetër –pavarësisht trazirave të përkohshme– përveç se për një bashkim më të fortë të të gjithë Popullit të Hyjit, e vetëdijshme për misionin e saj shpëtues.

Pikërisht në lidhje me këtë ndërgjegje të përkohshme të Kishës, Pali VI bëri temën e tij të parë themelore Enciklike, që fillon me fjalët *Ecclesiam Suam*, dhe nga kjo Enciklikë më lejoni, para së gjithash, të bëj referencë dhe ta lidh me këtë hyrje, apo dokument përrues të këtij papati. E ndriçuar dhe e mbështetur nga Shpirti Shenjtë, Kisha ka një ndërgjegje gjithmonë e më të thelluar, si në lidhje me mbarështimin e saj hyjnor, si me misionin e saj njerëzor, por së fundi edhe me vetë dobësitë e saj njerëzore: dhe është pikërisht kjo ndërgjegje që është dhe duhet të mbetet burimi i parë i dashurisë së kësaj Kise, ashtu si dashuria, nga ana e saj, kontribuon për të fortifikuar dhe thelluar ndërgjegjen. Pali VI na ka lënë dëshminë e një ndërgjegjeje të tillë, ekstremisht akute, të Kishës. Përmes komponentëve të shumta dhe të pësuar shpesh të papatit të tij, ai na ka mësuar dashurinë e patrembur ndaj Kishës, e cila- siç konfirmon Koncili- është «Sakrament, ose shenjë dhe mjet i bashkimit intim me Hyjin dhe i bashkimit të gjithë njerëzimit»<sup>9</sup>.

### 4. Referencë ndaj Enciklikës së parë të Palit VI

Pikërisht për këtë arsye, ndërgjegja e Kishës duhet të bashkohet me një hapje universale, në mënyrë që të gjithë të mund të gjejnë në të «pasurinë e pashqyrtueshme të Krishtit»<sup>10</sup>, për të cilën flet Apostulli i njerëzve. Një hapje e tillë, në mënyrë organike e bashkuar me ndërgjegjen e natyrës së vet, me sigurinë e së vërtetës së vet, për të cilën Krishti tha: «e fjala që po dëgjoni, nuk është imja, por është e Atij, që më dërgoi, -e Atit»<sup>11</sup>, përcakton një dinamizëm apostolik, pra misionar, të Kishës, e cila deklaron dhe shpall plotësisht të gjithë të vërtetën e trasmetuar nga Krishti. Në të njëjtën kohë, ajo duhet të kryejë atë dialog që Pali VI në Enciklikën e tij *Ecclesiam Suam* e quan «dialogu i shpëtimit», duke i dalluar saktësisht rrethet individuale, brenda kuadrut të së cilëve duhet të kryhen<sup>12</sup>. Ndërsa sot i referohem këtij dokumenti programatik të papatit të Palit VI, nuk pushoj së falenderuari Zotin, sepse ky Paraardhës i madh i imi dhe baba i vërtetë, ka ditur pavarësisht dobësive të ndryshme të brendshme, nga të cilat ka vuajtur Kisha në periudhën pas-Koncilit, të manifestojë «ad extra», «nga jashtë» fytyrën autentike. Në këtë mënyrë, edhe pjesa më e madhe e familjes

njerëzore, në fusha të ndryshme të ekzistencës së saj të shumëfishtë, është bërë, -sipas këndvështrimit tim-më e vetëdijshme se si për të është me të vërtetë e nevojshme Kisha e Krishtit, misioni dhe shërbimi i saj. Kjo vetëdije është shfaqur ndonjëherë më e fortë se disa qëndrime kritike, që sulmonin «ab intra», «nga brenda» Kishën, institucionet dhe strukturat e saj, njerëzit e kishës dhe aktivitetet e tyre. Kjo kritikë në rritje, ka patur patjetër shkaqet e saj të ndryshme, dhe jemi të sigurt, nga ana tjetër, që nuk ka qenë gjithmonë pa një dashuri të vërtetë ndaj Kishës. Pa dyshim, është manifestuar në të, ndër të tjera, tendenca për të kapërcyer të ashtuquajturin triumfalizëm që shpesh diskutohej gjatë Koncilit. Por, nëse është gjëja e duhur, që Kisha, duke ndjekur shembullin e Mësuesit të saj, «që ishte zemër butë e i përvujtë»<sup>13</sup>, të jetë e bazuar edhe ajo në përvullësi, të ketë një sens kritik në lidhje me gjithçka që ndërton karakterin e saj, dhe aktivitetin e saj njerëzor, të jetë gjithmonë shumë kërkuese ndaj vetvetes, po kështu edhe shpirti kritik duhet të ketë kufijtë e tij të duhur. Në të kundërt, ajo ndalon së qeni konstruktive, nuk zbulon të vërtetën, dashurinë dhe mirënjohjen për hirin, nga të cilat bëhemi kryesisht dhe plotësisht pjestarë të Kishës dhe me anë të Kishës. Përveç kësaj, ajo nuk shpreh qëndrimi e shërbimit, por më tepër vullnetin për të drejtuar mendimin e të tjerëve sipas mendimit të vet, ndonjëherë duke e përhapur në mënyrë të pakujdesshme. Duhet t'i jemi mirënjohës Palit VI, sepse duke respektuar çdo copëz të së vërtetës që gjendej në opinionet e njerëzimit, ka ruajtur në të njëjtën kohë ekuilibrin providencial të drejtuesit të Barkës<sup>14</sup>. Kisha e cila, nëpërmjet Gjon Palit I dhe pothuajse menjëherë pas tij m'u besua, nuk është me siguri pa vështirësi dhe tensione të brendshme. Por, në të njëjtën kohë, ajo është e përgatitur në brendësi kundër autokritikës së tepërt, mund të thuhet që është më kritikuese përballë disa kritikave të pakujdesshme, më rezistente përballë «risive» të ndryshme, më e pjekur në shpirtin e mprehtësisë, më e prirur për të nxjerrë nga thesari i saj shumëvjeçar «gjëra të reja e të vjetra»<sup>15</sup>, më e përqëndruar në misterin e saj, dhe falë kësaj, më e disponueshme për misionin e shpëtimit të të gjithëve: «Hyji don që të shëlbohen të gjithë njerëzit dhe t'ia arrijnë njohjes së vërtetës»<sup>16</sup>.

## 5. Kolegjialitet dhe apostullim

Kjo Kishë është -në të kundërt nga ajo që duket- më e bashkuar në bashkësinë e shërbimit, dhe në ndërgjegjen e apostollimit. Një bashkim i tillë buron nga ai parim i kolegjialitetit, i përmendur nga Koncili i II i Vatikanit, që Krishti vetë futi në kolegjin e të dymbëdhjetëve, më Pjetrin në krye, e që ripërtërihet vazhdimisht në kolegjin e Ipeshkvinjëve, i cili po zgjerohet gjithnjë e më shumë në të gjithë tokën, duke qëndruar i bashkuar me pasuesin e Shën Pjetrit dhe nën drejtimin e tij. Koncili jo vetëm e ka rikujtuar këtë parim të kolegjialitetit të Ipeshkvinjëve, por e ka gjallëruar jashtëzakonisht, ndër të tjera, duke bërë thirrje për themelimin e një organi të ri të përhershëm që Pali VI krijoj me ndërtimin e Sinodit të Ipeshkvinjëve, aktiviteti i të cilit, jo vetëm i dha një dimension të ri Papatit të tij, por në vazhdim, është reflektuar në mënyrë të qartë, që në ditët e para, të papatit të Gjon Palit I, dhe në atë të pasardhësit të tij të padenjë.

Parimi i kolegjialitetit është shfaqur veçanërisht aktual në periudhën e vështirë pas-Koncilit, kur pozita e përbashkët dhe njëzëri e Ipeshkvinjëve- që sidomos me anë të Sinodit, ka manifestuar bashkimin e saj me pasardhësin e Pjetrit- kontribuonte në zhdukjen e dyshimeve, dhe në të njëjtën kohë tregonte mënyrat e duhura të rinovimit të Kishës, në dimensionin e saj universal. Në të vërtetë, nga Sinodi ka buruar ndër të tjera, impulsi i ungjillëzimit, që e ka gjetur shprehjen e tij në Letrën Apostolike *Evangëlii Nuntiandi*<sup>17</sup>, i pranuar me shumë gëzim si program rinovues me karakter apostolik dhe baritor gjithashtu. E njëjta linjë është ndjekur edhe në punët e seancës së fundit të zakonshëm të Sinodit të Ipeshkvinjëve, i cili u zhvillua një vit para vdekjes së Papës Pali VI, dhe iu dedikua- sikurse dihet- katekezës. Rezultatet e saj pune kanë akoma nevojë për një sistemim dhe një parashtrim nga ana e Selisë Apostolike.

Duke qenë se jemi duke trajtuar zhvillimin e dukshëm të formave në të cilat shprehet kolegjialiteti ipeshvnorë, është e nevojshme të paktën të kujtojmë procesin e konsolidimit të Konferencave Ipeshkvnore kombëtare në të gjithë Kishën dhe të strukturave të tjera kolegjiale me karakter ndërkombëtar dhe kontinental. Duke ju referuar pastaj, traditës shekullore të Kishës, duhen theksuar aktivitetet e Sidodave vendore të ndryshme. Në fakt, qe ideja e Koncilit, e zbatuar në mënyrë koherente nga Pali VI, që strukturat e ketij lloji, të eksperimentuara ndër shekuj nga Kisha, ashtu si format e tjera të bashkëpunimit kolegjial të

ipeshkvinjëve, për shembull metropolia, për të mos folur akoma për secilën dioqezë, pulsonin me vetëdije të plotë për identitetin e tyre, dhe bashkë me origjinalitetin e tyre, në unitetin universal të Kishës. E njejta frymë bashkëpunimi dhe bashkëpërgjegjësie po përhapet edhe mes meshtarëve, dhe kjo vërtetohet edhe nga Këshillet e shumta meshtarake që u ngritën pas Koncilit. Kjo frymë është përhapur edhe mes laikëve, duke konfirmuar jo vetëm organizatat apostolike ekzistuese, por duke krijuar edhe të reja, që shpesh kanë një profil të ndryshëm dhe një dinamikë të jashtëzakonshme. Për më tepër, laikët, të vetëdijshëm për përgjegjësitë e tyre kundrejt Kishës, janë angazhuar me dëshirë në bashkëpunimin me Barinjët, me përfaqësuesit e Instituteve të jetës së shuguruar, në fushën e sinodeve dioqezanë ose këshilla baritore në famulli dhe dioqeza.

Për mua është e nevojshme ta kem në mendje të gjithë këtë në fillim të Papatit tim, për të falenderuar Zotin, për t'ju shprehur një inkurajim të fortë të gjithë Motrave dhe Vëllëzërve, dhe për të kujtuar gjithashtu me një mirënjohje të thellë veprën e Koncilit të II të Vatikanit dhe të paraardhësve të mi të mëdhenj, që e kanë filluar këtë «valë» të re në jetën e Kishës, motor shumë më e fuqishme se simptomat e dyshimit, të kolapsit dhe të krizës.

## 6. Rruga e bashkimit të të krishterëve

E çfarë mund të thuhet për të gjitha nismat që dalin nga orientimi i ri ekumenik? I paharrueshmi Papa Gjoni XXIII, me një qartësi ungjillore, e vendosi problemin e bashkimit të të krishterëve si një pasojë e thjeshtë e vullnetit të vetë Jezu Krishtit, Mësuesit tonë, e pohuar disa herë, dhe e shprehur në mënyrë të veçantë në lutjen e çenakullit, në vigjilie të vdekjes së Tij: «Lutem..., Atë..., që të gjithë të jenë një»<sup>18</sup>. Koncili i II i Vatikanit iu përgjigj kësaj kërkesë në formë koinçize me Dekretin mbi ekumenizmin. Papa Pali VI, duke u ndihmuar nga aktiviteti i Sekretariatit për bashkimin e të Krishterëve, filloi hapat e parë të vështirë në rrugën e arritjes së një bashkimi të tillë. Kemi shkuar larg në këtë rrugë? Pa dashur të jap një përgjigje të detajuar, mund të them që kemi bërë progres të vërtetë dhe të rëndësishëm. Dhe një gjë është e sigurt: kemi punuar me këmbëngulje dhe koherencë, dhe bashkë me ne janë angazhuar edhe përfaqësues të Kishave të tjera dhe Komuniteteve të tjera të krishtera, dhe për këtë iu detyrohemi sinqerisht. Është e sigurt, gjithashtu, që në situatën historike aktuale të krishtërimit dhe të botës, nuk duket ndonjë mundësi tjetër për përmbushjen e misionit universal të Kishës, për sa i përket problemeve ekumenike, përveç se të kërkohet me besnikëri, me këmbëngulje, me përlësi dhe me kurajo, rrugët e afrimit dhe të bashkimit ashtu siç na e ka dhënë shembullin personal Papa Pali VI. Prandaj, duhet ta kërkojmë bashkimin pa u shkurajuar përballë vështirësive, që mund të paraqiten dhe të grumbullohen gjatë kësaj rruge; përndryshe nuk do të jemi besnik ndaj Fjalës së Zotit, nuk do ta reallizojmë testamentin e tij. Është e lejueshme të rrezikojmë këtë?

Ka persona që, duke u gjendur përballë vështirësive, ose duke i gjykuar negative rezultatet e punëve fillestare ecumenike, do kishin dabsur të tërhiqen. Madje disa shprehin opinionin që këto sforcime dëmtojnë për shkak të Ungjillit, çojnë në një përçarje të mëtejshme të Kishës, provokojnë ngatërrim idesh në çeshtjet e fesë dhe të moralit, të çojnë drejt një indiferentizmi të veçantë. Ndoshta do të ishte mirë që zëdhënësit e këtyre opinioneve të shprehnin frikat e tyre; megjithatë, edhe në lidhje me këtë është e nevojshme të vendosen kufijtë e duhur.

Sigurisht që kjo etapë e re e Kishës kërkon nga ne një fe veçanërisht të vetëdijshme, të thelluar dhe të përgjegjshme. Aktiviteti i vërtetë ekumenik do të thotë hapje, afrim, disponueshmëri për dialog, kërkim i përbashkët i së vërtetës në kuptimin e plotë ungjillore dhe të krishterë; por kjo nuk do të thotë absolutisht të heqësh dorë ose të shkaktohet në çfarëdo lloj mënyre paragjykim për thesaret e së vërtetës hyjnore, e rrëfyer dhe e mësuar vazhdimisht nga Kisha. Të gjithë atyre që, për çfarëdo lloj arsyeje, do të donin të shkurajoni Kishën në përpjekjen për bashkimin e të krishterëve, është e nevojshme ta përsërisim edhe një herë: është e lejueshme për ne mos ta bëjmë? A mundemi- pavarësisht gjithë dobësisë njerëzore dhe të gjitha mangësive të grumbulluara në shekujt e kaluar- mos të kemi besim në hirin e Zotit Tonë, i cili është zbuluar, në kohët e fundit, përmes fjalës së Shpirtit Shenjtë, që kemi dëgjuar gjatë Koncilit? Duke bërë kështu, do mohonim të vërtetën që ka të bëjë me veten tonë dhe që apostulli e ka shprehur shumë



rrjedhshëm: «Por, në sajë të hirit të Hyjit, jam ky që jam; dhe hiri i tij në lidhje me mua nuk ka qenë i kotë»<sup>19</sup>.

Edhe pse në një mënyrë tjetër dhe me dallimet e nevojshme, duhet të aplikojmë atë që është thënë në aktivitet që tenton në afrimin e përfaqësuesve të religjioneve jo të krishtera, dhe që shprehet me anë të dialogut, kontakteve, lutjes bashkësiore, kërkimit të thesareve të shpirtit njerëzor, të cilët -siç e dimë- nuk iu mungojnë as anëtarëve të këtyre religjioneve. Nganjëherë ndoshta nuk ndodh që besimi i fortë i ndjekësve të besimeve jo të krishtera- efekt, dhe ky, i Shpirtit të së vërtetës, që vepron përtej kufijve të dukshëm të Trupit mistik- të mundet t'i hutojë të krishterët, që shpesh janë kaq të gatshëm për të dyshuar, ne vend të të vërtetave të zbuluara nga Hyji, dhe të shpallura nga Kisha, kaq të prirur për zbutjen e parimeve të moralit dhe për të hapur rrugën e tolerancës etike? Është fisnike të jemi të predispozuar të kuptojmë çdo njeri, të analizojmë çdo sistem, t'i japim të drejtë asaj që është e duhura; por kjo nuk do të thotë absolutisht të humbim sigurinë e fesë tonë<sup>20</sup>, apo të dobësojmë parimet e moralit, mungesa e të cilëve ndihet shumë shpejt në të gjithë shoqërinë, duke shkaktuar, ndër të tjera, pasoja të mjerueshme.

## II- Misteri i shëlbimit

### 7. Në misterin e Krishtit

Nëse rrugët, në të cilat Koncili i shekullit tonë e ka vënë Kishën, rrugë që na i ka treguar në letërën e tij të parë i ndjeri Papa Pali VI, do qëndrojnë për shumë kohë ekzaktësisht ato që ne duhet të ndjekim, në të njejtën kohë, në këtë etapë të re, me të drejtë mund të pyesim: Si? Në çfarë mënyrë duhe të vazhdojmë? Çfarë duhet bërë, me qëllim që kjo Ardhje e re e Kishës, tashmë e bashkuar me fundin e ardhshëm të mijëvjeçari të dytë, ti afrohet Atij që Shkrimi i Shenjtë quan: «Atë i amshueshëm», *Pater futuri saeculi?*<sup>21</sup>. Kjo është pyetja kryesore që Papatë i ri duhet të shtrojë, kur, i firmëzuar nga bindja e besimit, pranon thirrjen sipas komandës së Krishtit, të drejtuar disa herë Pjetrit: «*Ruaj delet e mia!*»<sup>22</sup>, që do të thotë: Ji bari i vathës time; dhe «...por ti, kur të kthehesh, forcoj vëllezërit e tu»<sup>23</sup>.

Dhe pikërisht këtu, të dashur Vëllezër, Bij dhe Bija, jepet një përgjigje themelore dhe thelbësore, pra: i vetmi orientim i shpirtit, i vetmi drejtim i intelektit, i vullnetit dhe i zemrës, për ne është ky: drejt Krishtit, Shpëtimtarit të njeriut; drejt Krishtit, Shpëtimtarit të botës. Nga ai duam të shikojmë, sepse vetëm në atë, Birin e Hyjit, është shpëtimi, duke ripërtërirë pohimin e Pjetrit: «*Te kush të shkojmë, Zotëri? Ti ke fjalët e jetës së pasosur*»<sup>24</sup>.

Përmes vetëdijes së Kishës, kaq shumë të zhvilluar nga Koncili, përmes të gjitha gradëve të kësaj vetëdije, përmes të gjitha fushave të aktiviteteve me anë të cilave Kisha shprehet, gjendet dhe konfirmohet, duhet të tentojmë vazhdimisht drejt Atij «që është Kryet»<sup>25</sup>, drejt Atij «prej të cilit është krijuar gjithçka e të cilit ne i përkasim»<sup>26</sup>, drejt Atij që është «*Udha, e Vërteta*»<sup>27</sup>, dhe «*Ngjallja dhe Jeta*»<sup>28</sup>, drejt Atij që duke e parë shohim Atin<sup>29</sup>, drejt Atij që i duhej të shkonte nga ne<sup>30</sup>, -nënkuptohet për vdekjen në Kryq dhe pastaj Ngjijtjen në Qiell- që Mbrojtësi të vijë tek ne dhe vazhdimisht të vijë si Shpirti i së Vërtetës<sup>31</sup>. Në të janë «të gjitha visaret e dijes dhe të kuptimit»<sup>32</sup>, dhe Kisha është trupi i tij<sup>33</sup>. Kisha është «në Krishtin si një sakrament, ose një shenjë dhe mjet i bashkimit intim me Hyjin, dhe të unitetit të të gjithë njerëzimit»<sup>34</sup>, dhe burimi i kësaj është Ai. Ai vetë! Ai Shëlbuesi!

Kisha nuk pushon së dëgjuari fjalët e ij, i lexon vazhdimisht, rindërton me devocionin më të madh, çdo veçanti të jetës së tij. Këta fjalë dëgjohen edhe nga jo të krishterët. Jeta e Krishtit iu flet në të njejtën kohë shumë njerëzve që nuk janë akoma në gjendje të përsërisin me Pjetrin: «Ti je Mesia - Biri i Hyjit të gjallë!»<sup>35</sup>. Ai, Biri i Hyjit të gjallë, ju flet njerëzve edhe si Njeri: është vetë jeta e tij që flet, humaniteti i tij, besnikëria dhe e vërteta e tij, dashuria e tij që i përqafton të gjithë. Flet gjithashtu, edhe vdekja e tij në kryq, thellësia e padepërtueshme e vujtjes dhe e braktisjes së tij. Kisha nuk pushon kujrrë së rijetuar vdekjen në kryq dhe Ringjalljen, që përbëjnë përmbajtjen e jetës së saj të përditshme. Në të vërtetë, Kisha kremton pa pushim Eukaristinë, në kujtim të vetë Krishtit, Mësuesit të saj, duke gjetur në të «burimin e jetës dhe të shenjtërisë»<sup>36</sup>, shenjë efektive e falenderimit dhe e pajtimit me Zotin, premtimi i jetës së amshuar.

Kisha jeton misterin e saj, iu tërheq pa u lodhur kurrë dhe kërkon vazhdimisht rrugët për ta afruar këtë mister të Mësuesit dhe Zotërisë së saj më njerëzimin: me popujt, kombet, brezat që ndjekin njëri-tjetrin, çdo person në veçanti, sikur të përsëriste gjithmonë sipas shembullit të Apostullit: «sepse nuk desha në mesin tuaj të di tjetër përveç Jezu Krishtit - dhe Atë të kryqëzuar»<sup>37</sup>. Kisha qëndron në sferën e misterit të Shëlbimit, që është bërë pikërisht parimi thelbësor i jetës dhe i misionit të saj.

## 8. Shëlbimi: Krijim i ripërtërirë

Shëlbuesi i botës! Në të është zbuluar, në një mënyrë të re dhe më të admirueshme, e vërteta themelore rreth krijimit, që Libri i Zanafillës e vërteton kur përsërit disa herë: «Hyji pa që ishte gjë e mirë»<sup>38</sup>. E mira e ka burimin e saj në Urti dhe në Dashuri. Në Jezu Krishtin, bota e dukshme, e krijuar nga Hyji për njeriun<sup>39</sup>, ajo botë që, pasi i ka hyrë mëkati, «është e nënshtruar kotësisë»<sup>40</sup>, - rimerr përsëri lidhjen origjinale me vetë burimin hyjnor të Urtësisë dhe Dashurisë. Në fakt, «Hyji aq fort e deshi botën sa që e dha një të vetmin Birin e vet...»<sup>41</sup>. Ashtu si në njeriun-Adam, kjo lidhje u thye, kështu në njeriun-Krisht, kjo lidhje është krijuar përsëri<sup>42</sup>. Nuk na bindin ndoshta, ne njerëzve të shekullit të njëzet, fjalët e Apostullit të popujve, të shqipëtuara me një elokuencë të madhe, rreth «krijesa (që) gjëmon dhe vuan në dhimbjet e lindjes deri tani»<sup>43</sup> dhe «me afsh e pret zbulimin e bijve të Hyjit»<sup>44</sup>, rreth krijimit që «i është nënshtruar kotësisë»? Përparimi i madh, i panjohur kurrë më parë, që është verifikuar, veçanërisht përgjatë shekullit tonë, në fushën e sundimit mbi botën nga ana e njeriut, nuk zbulon ndoshta vetë atë, dhe për më tepër në gradë që nuk është arritur kurrë më parë, atë nënshtrim shumëdimensional “kotësisë”? Këtu mjafton të kujtojmë disa fenomene, si kërcënimi i ndotjes së mjedisit natyror në vendet me industrializim të shpejtë, ose konfliktet e armatosura që shpërthejnë dhe përsëriten vazhdimisht, apo perspektivat e vetëshkatërrimit me anë të përdorimit të armëve atomike, të hidrogjenit, neututronit, e të tjera si këto, mungesa e respektit për jetën e të pa lindurve. Bota e epokës së re, bota e fluturimeve kozmike, bota e arritjeve shkencore dhe teknike, të paarritura kurrë më parë, nuk është po ashtu bota që «gjëmon dhe vuan»<sup>45</sup>, dhe «me afsh e pret zbulimin e bijve të Hyjit»<sup>46</sup>.

Koncili i II i Vatikanit, në analizën e tij të thelluar «të botës bashkëkohore», arrinte në atë pikë që më i rëndësishmi i botës së dukshme, njeriu, duke zbritur –si Krishti– në thellësinë e ndërgjegjes njerëzore, duke prekur misterin e brendshëm të njeriut, që në fjalorin biblik, (dhe në atë jo biblik) shprehet me fjalën «zemër». Krishti, Shëlbuesi i botës, është ai që ka depërtuar në mënyrë unike dhe të papërsëritshme në misterin e njeriut dhe ka hyrë në zemrën e tij. Me të drejtë, pra, Koncili i II i Vatikanit, na mëson:

«Në fakt, vetëm në misterin e Fjalës së mishëruar gjen dritë të vërtetë misteri i njeriut. Adami, në fakt, njeriu i parë ishte prototip i atij të së ardhmes (Rm 5, 14), pra i Krishtit Zot. Krishti, që është Adami i ri, pikërisht duke zbuluar misterin e Atit dhe të Dashurisë së tij, i zbulon gjithashtu plotësisht, njeriun njeriut, dhe i bën të ditur thirrjen e tij të lartë». Dhe akoma: «Ai është shëmbëllesha e Hyjit të papashëm (Col 1, 15). Ai është njeriu perfekt, që i ka rikthyer binjve të Adamit ngjashmërinë me Hyjin, e prishur që nga mëkati i parë. Pasi ai ka marrë natyrën njerëzore, pa e asgjësuar, prandaj kjo ka qenë edhe në të mirën tonë e ngritur në një dinjitet sublim. Më mishërimin e tij, në fakt, vetë biri i Hyjit, është bashkuar në një frë mënyre me çdo njeri. Ka punuar me duar njeriu, ka menduar me mendje njeriu, ka vepruar me vulnet njeriu, ka dashur me zemër njeriu. Duke lindur nga virgjëra Mari, Ai është bërë me të vërtetë njëri nga ne, në gjithçka i ngjashëm me ne, më përjashtim të mëkatis»<sup>47</sup>.

Ai, Shëlbuesi i njeriut!

## 9. Dimensio i hyjnor i misterit të Shëlbimit

Duke reflektuar sërish mbi këtë tekst të mrekullueshëm të Magjisterit këshillor, mos të harrojmë, për asnjë moment, që Jezu Krishti, Biri i Hyjit të gjallë, është pajtuesi ynë me Atin<sup>48</sup>. Pikërisht ai, vetëm ai e ka përmbushur dashurinë e përjetshme të Atit, në atë atësi që është shprehur që nga fillimi në krijimin e botës,

duke i dhuruar njeriut gjithë pasurinë e krijimit, duke e bërë atë «pak më të vogël së engjëjt»<sup>49</sup> duke qenë i krijuar «në shëmbëlltyrën dhe përngjasimin e Hyjit»<sup>50</sup>; dhe, po ashtu e ka përmbushur me atë atësi të Hyjit dhe me atë Dashuri, e refuzuar në një farë mënyre nga njeriu, me prishjen e Aleancës së parë<sup>51</sup>, dhe atyre pasardhëse, që Zoti «shumë herë iu ka ofruar njerëzve»<sup>52</sup>. Shëlbimi i botës, ky mister tronditës i dashurisë, në të cilin rinovohet krijimi<sup>53</sup>- është, në rrënjët e saj më të thella, plotësia e drejtësisë në një Zemër njerëzore: në zemrën e Birit të paralindur, që kjo të mund të bëhet drejtësia e zemrave të shumë njereëzve, të cilët pikërisht në Birin e paralindur, kanë qenë të paracaktuar, që në përjetësi, të bëhen bijtë e Hyjit<sup>54</sup>, dhe të thirren në hir dhe në dashuri. Kryqi mbi Kalvar, nëpërmjet të cilit Jezu Krishti –njeri, biri i Virgjërës Mari, biri i supozuar i Jozefit të Nazaretit– “lë” këtë botë, është në të njëjtën kohë një manifestim i atësisë së përjetshme të Hyjit, i cili në Të i afrohet sërish njerëzimit, çdo njeriu, duke i dhënë tri herë të shenjtin «Shpirtin e së vërtetës»<sup>55</sup>.

Me këtë zbulim të Atit, dhe përhapje të Shpirtit Shenjtë, që shypen një vulë të pashlyeshme mbi misterin e Shëlbimit, shpjegohet kuptimi i kryqit dhe i vdekjes së Krishtit. Hyji i krijimit, shfaqet si Hyji i Shëlbimit, si Hyji «besnik ndaj vetvetes»<sup>56</sup>, besnik ndaj dashurisë së tij për njeriun dhe për botën, e zbuluar qysh prej ditës së krijimit. Dhe dashuria e Tij, është e tillë që nuk tërhiqet përballë asgjëje që në Të kërkon drejtësinë. Prandaj Birin «që nuk bëri mëkat, Hyji për ne e bëri mëkat»<sup>57</sup>. Nëse «e bëri të jetë mëkat» Atë që ishte absolutisht pa asnjë mëkat, e bëri për të zbuluar dashurinë që është gjithmonë më e madhe se gjithë krijimi, dashurinë që është vetë Ai, sepse «Hyji është Dashuri»<sup>58</sup>. Dhe mbi të gjitha, dashuria është më e madhe se mëkati, se dobësia, se kotësia e krijimit<sup>59</sup>, më e fortë se vdekja, është dashuri gjithmonë e gatshme për të ngritur dhe për të falur, gjithmonë e gatshme për t’i shkuar në takim birit të humbur<sup>60</sup>, gjithmonë duke kërkuar «zbulimin e bijve të Hyjit»<sup>61</sup>, që janë të thirrur në Lumturinë e ardhshme<sup>62</sup>. Kjo zbuluesë e dashurisë përkufizohet edhe si mëshirë<sup>63</sup>, dhe kjo zbuluesë e dashurisë dhe e mëshirës, ka një formë dhe një emër në historinë e njeriut: quhet Jezu Krisht.

## 10. Dimensioni njerëzor i misterit të Shëlbimit

Njeriu nuk mund të jetojë pa dashuri. Ai mbetet një qenie e pakuptueshme, jeta e tij nuk ka kuptim, nëse nuk i zbulohet dashuria, nëse nuk takohet me dashurinë, nëse nuk e provon dhe nuk e bën të tijën, nëse nuk mer pjesë fuqishëm. Dhe pikërisht për këtë, Krishti Shëlbues –siç e kemi thënë dhe më përpara– i zbulon plotësisht njeriut, vetë njeriun. Kjo është –nëse është e lejueshme të shprehet kështu- dimensionin njerëzor i misterit të Shëlbimit. Në këtë dimension, njeriu rigjen madhësinë, dinjitetin dhe vlerat e humanitetit të tij. Në misterin e Shëlbimit, njeriu vjen “i shprehur” përsëri, dhe në një farë mënyre, i krijuar përsëri. Ai është i krijuar përsëri! «Nuk ka më: hebre-grek! Nuk ka më: skllav/i lirë! Nuk ka më: mashkull/femër! Të gjithë ju jeni NJË në Krishtin Jezus!»<sup>64</sup>. Njeriu që do ta kuptojë vetveten deri në fund –jo thjesht sipas kriterëve dhe masave të menjëhershme, të pjesshme, shpesh sipërfaqësore, dhe në fund të dukshme të vetë qenies së tij,– me trazirat dhe pasigurinë e tij, por edhe me dobësinë dhe mëkatin e tij, me jetën dhe vdekjen e tij duhet të afrohet me Krishtin. Ai duhet, le të themi, të futet në Të me gjithë qenien e tij, duhet «të përshtatet» dhe të asimilojë të gjithë të vërtetën e Mishërimit dhe të Shëlbimit, për të rigjetur vetveten. Nëse në të zhvillohet ky proces i thellë, atëherë ai prodhon fryte jo vetëm të adhurimit të Zotit, por edhe të një mrekullie të thellë të vetvetes. Çfarë vlerë duhet të ketë njeriu para syve të Krijuesit nëse, «ka merituar të ketë një Shëlbues kaq të madh dhe fisnik»<sup>65</sup>, nëse «Hyji ka dhënë Birin e tij», me qëllim që Ai, njeriu, «të mos birret, por ta ketë jetën e pasosur»<sup>66</sup>.

\*Në të vërtetë, kjo mahnitje e madhe rreth vlerës dhe dinjitetit të njeriut quhet Ungjill, pra Lajmi i Mirë. Quhet edhe Krishtërim. Kjo mahnitje, justifikon misionin e Kishës në botë, si dhe, ndoshta më shumë akoma «në botën bashkëkohore». Kjo habi, bindje dhe siguri së bashku, që në rrënjën e saj më të thellë është siguria e fesë, por që në mënyrë të fshehtë dhe misterioze gjallëron çdo aspekt të humanizmit autentik, është e lidhur ngusht me Krishtin. Kjo përcakton edhe vendin e tij, të drejtën e tij të qytetarisë – nëse mund të thuhet kështu– në historinë e njeriut dhe të njerëzimit. Kisha që nuk pushon së medituarit misterin e Krishtit, di me gjithë sigurinë e fesë, që Shëlbimi, i ardhur nëpërmjet kryqit, i ka ridhënë përfundimisht njeriut dinjitetin dhe kuptimin e ekzistencës së tij në botë, kuptimin që e kishte humbur

masivisht për shkak të mëkatit. Dhe prandaj Shëkbimi është kryer në misterin e Pashkës, që nëpërmjet kryqit dhe vdekjes, çoj në ringjallje.

Detyra kryesore e Kishës në të gjitha epokat, dhe në mënyrë të veçantë në epokën tonë, është të drejtojë shikimin e njeriut, të adresojë vetëdijen dhe eksperiencën e njeriut drejt misterit të Krishtit, të ndihmojë të gjithë njerëzit që të kenë familjaritet me Shëlbimin, që vjen në Krishtin Jezus. Njëkohësisht, preket edhe sfera më e thellë e njeriut, –nenkuptojmë– e zemrave njerëzore, e ndërgjegjeve njerëzore dhe e ngjarjeve njerëzore.

## 11. Misteri i Krishtit, themeli i misionit të Kishës

Koncili i II i Vatikanit, ka kryer një punë shumë të madhe për të formuar këtë ndërgjegje të plotë dhe universale të Kishës, për të cilën shkruante Papa Pali VI në Letrën e tij të parë. Një ndërgjegje e tillë –ose për më tepër vetëndërgjegjia e Kishës– formohet «në dialogun» i cili para se të kthehet në bashkëbisedim, duhet ta drejtojë vëmendjen tij drejt «tjetrit», pra drejt atij me të cilin duam të flasim. Koncili ekumenik, ka dhënë një impuls thelbësor për formimin e vetëndërgjegjes së Kishës, duke i ofruar në mënyrë shumë të përshtatshme dhe kompetente, vizionin e globit tokësor, si një «hartë» me religjionet e ndryshme. Përveç kësaj, kjo ka demonstruar se si mbi këtë hartë të religjioneve të botës mbivendoset me shtresa- të panjohura më përpara dhe karakteristike të kohës sonë- fenomeni i ateizmit në format e tij të ndryshme, duke filluar nga ateizmi i programuar, organizuar dhe sistemuar në një sistem politik.

Sa për religjionin, bëhet fjalë së pari për besimin si fenomen universal, i bashkuar me historinë e njerëzimit që nga filimi; pastaj për besimet e ndryshme jo të krishtera, dhe së fundi, për vetë krishtërimin. Dokumenti i Koncilit dedikuar besimeve jo të krishtera është, në veçanti i mbushur me stimë të thellë, për vlerat e mëdha shpirtërore, madje, për përparësinë e asaj që është shpirtërore dhe gjen në jetën e njerëzimit shprehinë e saj në fe dhe në moral, me ndikime të drejtpërdrejta në gjithë kulturën. Me të drejtë Etërit e Kishës shikonin në besime të ndryshme reflektime të shumtë të një të vërtete të vetme, si «germat e Fjalës»<sup>67</sup>, të cilat dëshmojnë që, megjithëse në rrugë të ndryshme, aspirata më e thellë e shpirtit njerëzor është e drejtuar në një drejtim, i cili shprehet me kërkimin e Hyjit dhe bashkë në kërkim, me anë të tensionit ndaj Hyjit, të dimensionit të plotë të njerëzimit, apo kuptimit të plotë të jetës njerëzore. Koncili i ka kushtuar një vëmendje të veçantë fesë hebraike, duke kujtuar trashëgiminë e madhe shpirtërore, e përbashkët për të krishterët dhe hebrenjtë, dhe ka shprehur vlerësimin e tij për besimtarët e Islamit, feja e të cilëve i referohet edhe Abrahamit<sup>68</sup>.

Për shkak të hapjes së bërë nga Koncili i II i Vatikanit, Kisha dhe gjithë të krishterët kanë mundur të arrijnë një vetëdije më të plotë të misterit të Krishtit, «mysterin e mbajtur fshehur gjatë shekujsh»<sup>69</sup> në Hyjin, për tu zbuluar më vonë: në Jezu Krishtin njeri, dhe për tu zbuluar vazhdimisht në çdo kohë. Në Krishtin dhe për Krishtin, Hyji i është zbuluar plotësisht dhe i është afruar përfundimisht njerëzimit, dhe në të njëjtën kohë, në Krishtin dhe për Krishtin, njeriu ka fituar vetëdijen e plotë të dinjitetit të tij, të lartësisë së tij, të vlerave trashëndente të humanitetit të tij, dhe të kuptimit të ekzistencës së tij.\*

Prandaj duhet që, të gjithë ne –që jemi ndjekës të Krishtit– të takohemi dhe të bashkohemi përreth Tij. Ky bashkim, në sektorë të ndryshëm të jetës, të traditës, të strukturave dhe të disiplinës së çdo Kisha apo Bashkësie kishtarë, nuk mund të kryhet pa një punë të vlefshme, që tenton njohjen reciproke dhe heqjen e pengesave në rrugën e një bashkimi perfekt.

Megjithatë, mundemi dhe duhet që tani, që të arrijmë dhe t'i tregojmë botës bashkimin tonë: në shpalljen e misterit të Krishtit, në zbulimin e dimensionit hyjnor dhe së bashku njerëzor të Shëlbimit, në luftimin me këmbëngulje të palodhshme për dinjitetin që çdo njeri ka arritur dhe mund të arrijë vazhdimisht në Krishtin. Ky është dinjiteti i hirit të adoptimit hyjnor, dhe gjithashtu dinjiteti i së vërtetës së brendshme së njerëzimit, i cili –nëse në ndërgjegjen e përbashkët të botës bashkëkohore ka arritur rëndësi thelbësore– shkëlqen edhe më shumë për ne në dritën e këtij realiteti që është Ai: Jezu Krishti.

Jezu Krishti është parim i qëndrueshëm dhe qëndër e përhershme e misionit, që vetë Hyji i ka besuar njeriut. Në këtë mision duhet të marrim pjesë të gjithë, në të duhet të përqëndrojmë të gjitha forcat tona, duke qenë më shumë se kurrë, i nevojshëm për njerëzimin e kohëve tona. Dhe nëse ky mision, duket se në

epokën tonë ndeshet me kundërshtime më të mëdha se në cilëndo kohë tjetër, kjo rrethanë tregon gjithashtu që misioni në epokën tonë, është akoma dhe më i nevojshëm dhe –pavarësisht kundërshtimeve– është më i pritur se kurrë. Këtu prekim, në mënyre indirekte, misterin e ekonomisë hyjnore, që ka bashkuar shpëtimin dhe hirin me kryqin. Jo më kot Krishti thotë se «Mbretëria e qiellit po pëson dhunën e vetëm të fortët e shtijnë në dorë»<sup>70</sup>; dhe që «bijtë e kësaj bote janë më të kujtueshëm në marrëdhënie të shoqishoqme se bijtë e dritës»<sup>71</sup>. Ta pranojmë me dëshirë këtë qortim, për të qenë si ata «dhunues të Hyjit», që kemi parë shumë herë në historinë e Kishës dhe vazhdojmë të shohim ende, për t'u bashkuar me vetëdije në misionin e madh, pra: të zbulojmë Krishtin në botë, të ndihmojmë çdo njeri që të gjejë vetveten në Të, të ndihmojmë brezat bashkëkohorë të vëllezërve dhe motrave tona, popujt, kombet, shtetet, njerëzimin, vendet ende e pa zhvilluara dhe vendet e pasura, të gjithë pra, për të njohur «pasurinë e pashqyrtueshme të Krishtit»<sup>72</sup>, sepse janë për çdo njeri dhe ndërtojnë të mirën e secilit.

## 12. Misioni i Kishës dhe liria e njeriut

Në këtë bashkim në mision, për të cilin vendos sidomos vetë Krishti, të gjithë të krishterët duhet të zbulojnë atë që i lidh tashmë sëbashku, që përpara se të realizohet bashkimi i tyre i plotë. Ky është bashkim apostolik dhe misionar, misionar dhe apostolik. Falë këtij bashkimi, mund t'i afrohem sëbashku trashëgimisë së mrekullueshme të shpirtit njerëzor, që është shfaqur në të gjitha religjionet, siç thotë Deklarata e Koncilit të II të Vatikanit *Nostra Aetate*<sup>73</sup>. Falë kësaj, i afrohem në të njëjtën kohë, të gjitha kulturave, të gjitha koncepteve idealogjike, të gjithë njerëzve me vullnet të mirë. Ju afrohem me atë vlerësim, respekt dhe mprehtësi, që, qysh prej kohës së apostujve, karakterizonte qëndrimin misionar dhe të misionarit. Mjafton të kujtojmë Shën Palin, dhe për shëmbull, diskutimin e tij para Aeropagës së Athinës<sup>74</sup>. Qëndrimi misionar fillon gjithmonë me një ndjenjë të thellë vlerësimi, përballë asaj që «çka njeriu ndryn përbrenda»<sup>75</sup>, për atë që ai vetë, në brendësinë e shpirtit të tij, ka përpunuar në lidhje me problemet më të thella dhe më të rëndësishme, bëhet fjalë për respekt ndaj gjithë asaj që shpirti ka vepruar në të, i cili «fryn në drejtimin që do»<sup>76</sup>. Misioni nuk është kurrë një shkatërrim, por është një rivendosje e vlerave dhe një ndërtim i ri, edhe pse praktikisht jo gjithmonë ka pasur një korrespondencë të plotë me një idal kaq të lartë. Dhe konvertimi, që duhet të marrë shkas nga këtu, e dimë shumë mirë që është vepër e hirit, në të cilin njeriu duhet të rigjejë plotësisht vetveten.

Për këtë arsye, Kisha e kohës tonë i jep një rëndësi të madhe të gjithë asaj që Koncili i II i Vatikanit ka shpallur në *Deklaratën mbi Lirinë Fetare [Dignitatis humanae]*, si në pjesën e parë ashtu dhe në të dytën e dokumentit<sup>77</sup>. E ndjejmë thellësisht karakterin impenjativ të së vërtetës që Hyji na ka zbuluar. Ndjejmë, veçanërisht, ndjenjën e madhe të përgjegjësisë për këtë të vërtetë. Kisha, si institucion i Krishtit, është mbrojtëse dhe mësuese, duke qenë në të vërtetë e pajisur me një ndihmë të veçantë të frymës së shenjtë, që të mund ta ruajë atë me besnikëri dhe ta bësojë në integritetin e duhur<sup>78</sup>. Duke përmbushur këtë mision, shohim vetë Krishtin, Atë që është ungjillëtari i parë<sup>79</sup>, dhe shohim edhe apostujt e tij, Martir dhe Rëfyes. *Deklarata mbi lirinë Fetare*, na tregon në mënyrë bindëse, se si Krishti, dhe më pas Apostujt e tij, në shpalljen e së vërtetës që nuk vjen nga njerëzit por nga Hyji, («*Mësimi im nuk është imi, por i Atij që më dërgoi*»<sup>80</sup>, pra i Atit), duke vepruar me gjithë forcën e shpirtin, kanë një vlerësim të thellë për njeriun, për intelektin e tij, vullnetin e tij, ndërgjegjen dhe lirinë e tij<sup>81</sup>. Në këtë mënyrë, vetë dinjiteti i qenies njerëzore, bëhet përmbajtja e atij lajmi\*, edhe pse pa shumë fjalë, nëpërmjet sjelljes ndaj tij. Një sjellje e tillë duket se korrisponдон më nevojat e veçanta të kohëve tona. Duke qenë se jo gjithmonë, ajo që sistemet e ndryshme apo njerëzit shohin ose krahasojnë me lirinë, është liria e vërtetë e njeriut, aq më shumë Kisha, me forcën e misionit të saj hyjnor, bëhet mbrojtëse e kësaj lirie, e cila është kushti dhe baza e dinjitetit të vërtetë që qenies njerëzore.

Jezu Krishti shkon të takojë njeriun e çdo epoke, ehde atë të epokës tonë, me të njëjtat fjalë: «do ta njihni të vërtetën, dhe e vërteta do t'ju bëjë njerëz të lirë»<sup>82</sup>. Këto fjalë përmbajnë një nevojë themelore si dhe një paralajmërim: nevoja për një marrëdhënie të sinqertë me të vërtetën, si kusht i një lirie autentike; dhe paralajmërim, që të shmangët çdo liri e dukshme, çdo liri sipërfaqësore dhe e njëanshme, çdo liri që nuk e depërton të gjithë të vërtetën mbi njeriun dhe mbi botën. Edhe sot, pas dymijë vitesh, Krishti shfaqet tek ne

si Dikush që sjell tek njeriu lirinë e bazuar tek e vërteta, si Dikush që e liron njeriun nga ajo që kufizon, gjymton dhe këput në rrënjë, në shpirtin e njeriut, në zemrën e tij, në ndërgjegjen e tij, këtë liri. Çfarë konfirmimi të mrekullueshëm kanë dhënë për këtë, dhe nuk pushojnë së dhëni ata që falë Krishtit dhe në Krishtin, kanë arritur lirinë e vërtetë dhe e kanë manifestuar atë edhe në kushtet e kufizimit të jashtëm!

Po Jezu Krishti vetë, kur u shfaq si i burgosur para tribunales së Pilatit, dhe u pyet nga ai në lidhje me akuzën e bërë nga përfaqësuesit e Sinedrios, a nuk u përgjigj vallë: «*E unë leva dhe erdha në botë për të dëshmuar të vërtetën*»<sup>83</sup>? Me këto fjalë të shqipëtuara para gjykatësit, në momentin vendimtar, ishte sikur po konfirmonte edhe një herë, një frazë të thënë edhe më përpara: «*Do ta njihni të vërtetën, dhe e vërteta do ju bëjë të lirë*». Përgjatë shumë shekujsh dhe shumë brezash, duke filluar që nga koha e Apostujve, a nuk është vetë Jezu Krishti që shfaqet pranë njerëzve të gjykuar për shkak të së vërtetës, dhe a nuk ka vdekur bashkë me njerëzit e dënuar për shkak të së vërtetës? A thua Ai pushon të jetë vazhdimisht zëdhënës dhe avokat i njeriut, që jeton «në shpirt e në të vërtetë»<sup>84</sup>? Pikërisht ashtu sikurse nuk ndalon të jetë përpara Atit, kështu është edhe ndaj historisë së njeriut. Dhe Kisha, nga ana e saj, pavarësisht vështirësive që janë pjesë e historisë së saj njerëzore, nuk ndalon së ndjekuri Atë që ka thënë:

*«Por po vjen koha -e tani është!- kur adhuruesit e vërtetë do ta adhurojnë Atin në shpirt e në të vërtetë, sepse Ati kërkon shi adhurues të tillë. Hyji është shpirt, dhe ata që e adhurojnë duhet ta adhurojnë në shpirt e në të vërtetë»*<sup>85</sup>.

### III- Njeriu i shëlbuar dhe situata e tij në botën bashkëkohore

#### 13. Krishti është bashkuar me çdo njeri

Kur, nëpërmjet eksperiencës së familjes njerëzore në rritje të vazhdueshme me ritëm të përshpjeluar, depërtojmë në misterin e Jezu Krishtit, kuptojmë më qartësisht që, në bazën e gjithë këtyre rrugëve përgjatë të cilave, në përputhje me urtësinë e Papa Pali VI<sup>86</sup>, duhet të vazhdojë Kisha e kohëve tona, ka një rrugë të vetme: është rruga e eksperimentuar prej shekujsh, dhe është po ashtu, rruga e së ardhmes. Krishti Zot na e ka treguar këtë rrugë, sidomos kur -siç tregon Koncili- «me mishërimin e Birit të Hyjit, është bashkuar në një farë mënyre me çdo njeri»<sup>87</sup>. \*Kisha e njeh, pra detyrën e saj themelore në sigurimin që një bashkim i tillë të kryhet dhe të rinovohet vazhdimisht. Kisha dëshiron të shërbejë këtë qëllim të vetëm: që çdo njeri të mund të rigjejë Krishtin, që Krishti të mundët, me çdo kënd, të përshkojë rrugën e jetës, me pushtetin e asaj të vërtete mbi njeriun dhe mbi botën, që gjendet në misterin e mishërimit dhe të Shëlbimit, me forcën e asaj dashurie që ajo rrezaton. Në sfondin e proceseve gjithmonë në rritje të historisë, që në epokën tonë duket se po japin fryte në mënyrë të veçantë në fushën e sistemeve të ndryshme, koncepteve ideologjike të botës dhe regjimeve, Jezu Krishti bëhet përsëri prezent në një farë mënyre, pavarësisht të gjithë mungesave të tij të dukshme, pavarësisht të gjitha kufizimeve të pranisë së tij në aktivitetet institucionale të Kishës. Jezu Krishti bëhet prezent me pushtetin e asaj të vërtete dhe dashurie, që janë shprehur në të si një plotësi unike dhe e papërsëritshme, megjithëse jeta e tij në tokë ka qenë e shkurtër, dhe aktiviteti i tij publik akoma më i shkurtër.

Jezu Krishti është rruga kryesore e Kishës. Ai vetë është rruga jonë: «në shtëpinë e Atit»<sup>88</sup>, dhe është rruga e çdo njeriu. Në këtë rrugë që të çon nga Krishti të njeriu, në këtë rrugë në të cilën Krishti bashkohet me çdo njeri, Kisha nuk mund të ndalohet nga askush. Kjo është nevoja për të mirën e përkohshme dhe të mirën e përrjetshme të njeriut. Kisha, për hir të Krishtit dhe për shkak të misterit që përbën vetë Kishën, nuk mund të qëndrojë e pandjeshme ndaj gjithë asaj që shërben për të mirën e vërtetë të njeriut, ashtu siç nuk mund të qëndrojë indiferente ndaj asaj asaj që e kërcënon. Koncili i II i Vatikanit, në pika të ndryshme të dokumentit të tij, ka shprehur këtë përkujdesje thlbësore të Kishës, në mënyrë që «jeta e botës “të jetë” më në përputhje me dinjitetin e shquar të njeriut»<sup>89</sup>, në të gjitha aspektet e saj, për ta bërë «gjithmonë e më njerëzore»<sup>90</sup>. Kjo është përkujdesja e vetë Krishtit, Bariut të mirë të të gjithë njerëzve. Në emër të një përkujdesjeje të tillë- sic thuhet në Kushtetutën baritore të Koncilit- «Kisha që, për shkak të misionit dhe kompetencës së saj, nuk shkrihet në asnjë mënyrë me komunitetin politik, dhe nuk ëhstë e lidhur me asnjë sistem politik, është shenja dhe roja e karakterit transhendent të njeriut»<sup>91</sup>.

Këtu, pra, bëhet fjalë për njëriun në të gjithë të vërtetën e tij, në dimensionin e tij të plotë. Nuk bëhet fjalë për njëriun “abstrakt”, por real, për njëriun “konkret”, “historik”. Bëhet fjalë për “çdo” njeri, sepse secili ka qenë i përfshirë në misterin e Shëlbimit, dhe Krishti është bashkuar me secilin, përgjithmonë, me anë të këtij misteri.

Çdo njeri vjen në botë i ngjizur në barkun e nënës, duke lindur nga nëna, dhe pikërisht për shkak të misterit të shëlbimit i besohet përkujdesjes së Kishës. Kjo përkujdesje ka të bëjë me njëriun në tërësi, dhe është e fokusuar tek ai në një mënyrë krejt të veçantë. Objekt i këtij kujdesi është njeriu, në dinjitetin e tij njerëzor unik dhe të papërsëritshëm, në të cilin ruan të paprekur imazhin e përngjasimin me vetë Hyjin<sup>92</sup>. Koncili tregon pikërisht këtë, kur, duke folur për këtë ngjashmëri, kujton që «njeriu në tokë është krijesa e vetme që Hyji ka dashur për veten e saj»<sup>93</sup>. Njeriu, ashtu siç është “i dashur” nga Hyji, ashtu siç është përjetësisht “i zgjedhur”, i thirrur dhe i destinuar nga Ai për Hir dhe për Lavdi [*ad gratiam et gloriam*]: pikërisht ky është çdo njeri, njeriu “më konkret”, “më real”; ky është njeriu në gjithë plotësinë e misterit nga i cili ai u bë pjesmarrës në Jezu Krishtin, mister në të cilin bëhet pjesëtar secili prej katër miliard njerëzve që jetojnë në planetin tonë, që nga momenti i ngjizjes nën zemrën e nënës.

#### 14. Të gjitha rrugët e Kishës çojnë tek njeriu

Kisha nuk mund ta braktisë njëriun, “fati” i të cilit, pra zgjedhja, thirrja, lindja dhe vdekja, shpëtimi ose humbja, janë të lidhura me Krishtin shumë ngushtë dhe në mënyrë të pandashme. Dhe bëhet fjalë për çdo njeri të këtij planeti, në këtë tokë që Krijuesi i ka dhënë njëriut të parë, duke i thënë burrit dhe gruas: «sundoheni atë! Bëhuni zotëruesit»<sup>94</sup>. Çdo njeri, në realitetin e tij të papërsëritshëm të të qenit dhe të vepruarit, të intelektit dhe të vullnetit, të ndërgjegjes dhe të zemrës. Njeriu, në realitetin e tij unik (sepse është “person”), ka një histori të veten të jetës së tij, dhe sidomos, një histori të veten të shpirtit të tij. Njeriu që, në përputhje me hapjen e jashtëm të shpirtit të tij, dhe bashkë me nevojat e shumta dhe të ndryshme të trupit të tij, të ekzistencës së tij të përkohshme, shkruan këtë historinë e tij personale me anë të lidhjeve, kontakteve, situatave, strukturave sociale të ndryshme, që e bashkojnë me njerëzit e tjerë, dhe këtë ai e bën që nga momenti i parë i ekzistencës së tij mbi tokë, nga momenti i ngjizjes dhe lindjes së tij. Njeriu, në të vërtetën e plotë të ekzistencës së tij, në qenien e tij personale, si dhe në qenien e tij komunitare dhe sociale- në sferën e familjes së tij, në sferën e shoqërisë dhe të konteksteve kaq të ndryshme, në sferën e kombit të vet, apo popullit (dhe, ndoshta akoma thjesht në fisin), në sferën e gjithë njerëzimit- ky njeri është rruga e parë që Kisha duhet të përshkojë në përmbushjen e misionit të saj: ai është rruga e parë dhe thelbësore e Kishës, rrugë e bërë nga vetë Krishti, rrugë e cila pandryshueshmërisht kalon nëpërmjet misterit të Mishërimit dhe të Shëlbimit.

Pikërisht ky njeri në gjithë të vërtetën e jetës së tij, në ndërgjegjën e tij, në prirjen e tij të vazhdueshëm drejt mëkatit, dhe sëbashku me aspiratën e tij të vazhdueshme për të vërtetën, për të mirën, për të bukurën, për drejtësinë, për dashurinë, pikërisht një njeri të tillë kishte parasysh Koncili i II i Vatikanit kur, duke përshkuar situatën e tij në botën bashkëkohore, shkante gjithmonë nga komponentet e jashtëm të kësaj situatë, tek e vërteta imanente e njerëzimit:

«Është pikërisht brenda njëriut, aty ku shumë elementë kundërshtojnë njëri-tjetrin. Nga njëra anë, në fakt, si krijesë ai eksperimenton në njëmijë mënyra kufij të tij; nga ana tjetër, ai e kupton që është pa kufij në aspiratat e tij dhe i thirrur për një jetë më të lartë. I nxitur nga shumë atraksione, ai gjithmonë detyrohet të zgjedhë disa dhe të heqë dorë nga të tjerat. Për më tepër, i dobët dhe mëkatar, jo rrallë bën atë që nuk do të donte, dhe nuk bën atë që do të donte. Për këtë ai vuan një përçarje në vetvete, nga e cila rrjedhin edhe shumë mosmarrëveshje të rënda në shoqëri»<sup>95</sup>.

Ky njeri është rrga e Kishës, një rrugë që ecën në një farë mënyre, në bazën e të gjitha atyre rrugëve, nëpër të cilat duhet të kalojë Kisha, sepse njëri- çdo njeri pa asnjë përjashtim- është shëlbuar nga Krishti, sepse me njëriun- çdo njeri pa asnjë përjashtim- Krishti është i bashkuar, edhe kur ai njeri nuk është i

vetëdoijshëm për këtë: «Krishti, i vdekur dhe i ringjallur për të gjithë, i jep gjithmonë njeriut», -çdo njeriu dhe të gjithë njerëzve- «...dritë dhe forcë për t'iu përgjigjur thirrjes së tij supreme»<sup>96</sup>.

Duke qenë pra, ky njeri, rruga e Kishës, rrugë e jetës dhe e eksperiencës së saj të përditshme, të mundit dhe misionit të saj, Kisha e kohës tonë duhet të jetë, gjithmonë në mënyrë të re, e vetëdoijshme për “situatën” e tij. Pra, duhet të jetë e vetëdoijshme për mundësitë e tij, që marrin gjithmonë një orientim të ri, dhe kështu shfaqen; Kisha duhet, në të njëjtën kohë, të jetë e vetëdoijshme për kërcënimet që i paraqiten njeriut. Duhet të jetë e vetëdoijshme gjithashtu, për gjithçka që duket së është e kundërta e përpjekjes që «jeta njerëzore, të bëhet gjithmonë e më njerëzore»<sup>97</sup>, që gjithçka që e përbën këtë jetë, t'i përgjigjet dinjitetit të vërtetë të njeriut. Më një fjalë, duhet të jetë e vetëdoijshme për gjithçka që është *kundër* këtij procesi.

### 15. Nga çfarë ka frikë njeriu bashkëkohor?

Duke e mbajtur të gjallë në kujtesë imazhin që na sjell Koncili i II i Vatikanit, në një mënyrë kaq të mprehtë dhe autoritare, do përpiqemi edhe një herë ta përshtasim këtë kornizë me “shenjat të kohës”, si dhe nevojat e situatës, që vazhdimisht ndryshon dhe zhvillohet në drejtime të caktuara.

Njeriu i sotëm duket se kërcënohet gjithmonë nga ajo që prodhon, pra nga rezultati i punës së duarve të tij, e akoma më shumë, nga puna e intelektit të tij, të tendencave të vullnetit të tij. Frytet e këtij aktiviteti të shumëfishtë të njeriut, shumë shpejt, dhe shpesh në mënyrë ta paparashikueshme, nuk janë thjesht objekt “tjetërsimi”, në kuptimin që ato hiqen nga ai që i ka prodhuar; kur, të paktën pjesërisht, në një rreth pasues dhe të tërthorë me efektet e tyre, këto fryte kthehen kundër vetë njeriut. Këto janë në fakt, të drejtuar, ose mund të jenë të drejtuara kundër tij. Në këtë duket së konsiston akti kryesor i dramës së ekzistencës njerëzore bashkëkohore, në dimensionin e saj më të gjërë universal. Prandaj njeriu jeton gjithmonë në frikë. Ai ka frikë se produktet e tij, natyrisht jo të gjitha dhe jo pjesa më e madhe, por disa, dhe pikërisht ata që përmbajnë një pjesë të veçantë të gjenialitetit dhe të iniciativës së tij, mund të kthehen në mënyrë radikale kundër vetë atij; ka frikë se mund të bëhen mjetë apo instrumente të një vetëshkatërrimi të paimagjinueshëm, përballë të cilit të gjitha fatkeqësitë apo katastrofat e historisë që ne njohim, duken të zbehta.

Prandaj duhet të lindë një pyetje: për çfarë arsye, kjo fuqi e dhënë njeriut që nga fillimi, fuqi me të cilën ai duhet të zotëronte tokën<sup>98</sup>, kthehet kundër vetë atij, duke shkaktuar një situatë shqetësuese të pakuptimtë, një frikë të vetëdoijshme dhe të pavetëdoijshme, kërcënim, që një farë mënyre i përcillet të gjithë familjes njerëzore bashkëkohore dhe manifestohet në aspekte të ndryshme?

Kjo gjendje kërcënim për njeriun, nga ana e produkteve të tij, ka drejtime dhe gradë të ndryshme të intensitetit. Duket se jemi gjithmonë e më të vetëdoijshëm për faktin që shfrytëzimi i tokës, i planetit në të cilin jetojmë, kërkon një planifikim racional dhe të ndershëm. Në të njëjtën kohë, një shfrytëzim i tillë për qëllime jo vetëm industriale, por edhe ushtarake, zhvillimi i teknikës së pakontrolluar apo përshtat në një plan më rreze universale dhe autentikisht humanist, sjellin shpesh me vete kërcënimin e ambjentit natyror të njeriut, e largojn nga marrëdhëniet e tij me natyrën, e shkëpusin nga ajo. Njeriu shpesh duket se nuk i percepton domethënjet e tjera të ambjentit të tij natyral, por vetëm ato që shërbejnë për një konsum a përdorim të mënjëhershëm. Në të kundërt, ishte vullneti i Krijuesit që njeriu të komunikonte me natyrën si “pronar”, dhe “kujdestar” i zgjuar dhe fisnik, dhe jo si “shfrytëzues” dhe “shkatërrues” pa marrë parasysh asgjë.

#### **[A thua progresi teknik është me të vërtetë në dobi të njeriut?]**

Zhvillimi i teknikës dhe zhvillimi i qytetërimit të kohës sonë, që është e shënuar nga vetë fusha e teknikës, kërkojnë një zhvillim proporcional të jetës morale dhe të etikës\*. Ndërkohë, duket se për fat të keq kjo e fundit qëndron gjithmonë prapa. Prandaj, ai proces kaq i mrekullueshëm, në të cilin është e vështirë mos të shohësh shënja autetike të madhështisë së njeriut, të cilët, në qelizat e tyre krijuese, janë zbuluar në faqet e Librit të Zanafillës, që në përshkrimin e krijimit të tij<sup>99</sup>, nuk mund mos të prodhojë shqetësime të shumta.

Shqetësimi i parë ka të bëjë me çështjen esenciale dhe thelbësore: ky proces, autori dhe përkrahësi i të cilit është njeriu, e bën jetën njerëzore në tokë, në çdo aspekt “më njerëzore”? E bën më të denjë për njeriun? Nuk ka dyshim që në disa aspekte e bën të tillë. Kjo pyetje, megjithatë, rikthehet fuqishëm për sa i përket



asaj që është esenciale në shkallën më të lartë: nëse njeriu, si njeri në kontekstin e këtij progresi, bëhet më të vërtetë më i mirë, pra më i pjekur shpirtërisht, më i ndërgjegjshëm për dinjitetin e humanitetit të tij, më i përgjegjshëm, më i hapur me të tjerët, veçanërisht me ata që kanë nevojë dhe janë me të dobëtit, me i gatshëm për të ndihmuar të tjerët.

Kjo është pyetja që duhet të bëjnë të krishterët, pikërisht sepse Jezu Krishti i ka sensibilizuar në mënyrë kaq universale rreth problemit të njeriut. Dhe të njëjtën pyetje duhet të bëjnë të gjithë njerëzit, veçanërisht ata që bëjnë pjesë në ato ambiente shoqërore, që i dedikohen në mënyrë aktive zhvillimit dhe progresit të kohëve tona.

Duke vëzhguar këto procese, dhe duke qenë pjesëmarrës në to, nuk mund të humbasim veten nga euforia, as nuk mund të bëhemi të njëanshëm nga entuziazmi i fitimeve tona, por të gjithë, me besnikëri absolute, me objektivitet dhe me sensin e përgjegjësisë morale, duhet të shtrojmë pyetjet themelore që kanë të bëjnë me situatën e njeriut, sot dhe në të ardhmën. Të gjitha fitimet e arritura deri tani, dhe ato të projektuara nga teknika për të ardhmen, a përputhen me progresin moral dhe shpirtëror të njeriut? Në këtë kontekst njeriu, si njeri, zhvillohet dhe përparon, apo pëson regres dhe degradon në humanitetin e tij?

A kryeson tek njerëzit, «në botën e njeriut»- që në vetvetë është një botë e së mirës dhe së keqes- e mira mbi të keqen? A rriten vërtetë tek njerëzit, mes njerëzve, dashuria shoqërore, respekti i të drejtave të të tjerëve- për çdo njeri, komb, popull- apo në të kundërt rriten egoizmat e dimensioneve të ndryshme, nacionalizmat e ekzagjeruara, në vend të dashurisë atentike të atdheut, si dhe tendenca për të dominuar të tjerët përtej të drejtave dhe meritave legjitime, dhe tendenca për të shfrytëzuar të gjithë progresin material tekniko-produktiv ekskluzivisht me qëllimin për të sunduar mbi të tjerët ose në favor të kësaj apo të imperializmit?

**[Ku gjendet humaniteti i njeriut?]**

Ja pyetjet themelore që Kisha nuk mund të mos shtrojë, sepse në mënyrë pak a shumë të qartë, i bënë miliardat e njerëzve që jetojnë sot në botë? Tema e zhvillimit dhe e progresit është në gojën e të gjithëve, dhe shfaqet në kolonat e të gjithë gazetave dhe publikimeve, në pothuajse të gjitha gjuhët e boës bashkëkohore. Por mos të harrojmë që, kjo temë nuk përmban vetëm pohime dhe siguri, por edhe pyetje dhe shqetësime të dhimbshme. Këto të fundit nuk janë më pak të rëndësishme se të parat.

Këto i përgjigjen natyrës së ndërgjegjes njerëzore, dhe akoma më shumë i përgjigjen nevojës themelore të perkujdesjes së njeriut për njeriun, për vetë humanitetin e tij, për të ardhmen e njerëzve mbi tokë. Kisha, që është e frymëzuar nga besimi eskatologjik, e konsideron këtë perkujdesje për njeriun, për humanitetin e tij, për të ardhmen e njerëzve mbi tokë, pra dhe për orientimin e zhvillimit dhe të progresit, si një element thembësor i misionit të saj, të lidhur në mënyrë të pazgjidhshme me të. Dhe parimin e kësaj perkujdesjeje ajo e gjen në vetë Krishtin, siç dëshmojnë Ungjijtë. Dhe për këtë arsye dëshiron ta rrisë vazhdimisht në Të, duke rishikuar situatën e njeriut bashkëkohor, sipas shenjave më të rëndësishme të kohës tonë.

## **16. Përparim apo kërcënim?**

Nëse pra, koha jonë, koha e brezit tonë, koha që po i afrohet fundit të Mijëvjeçarit të dytë, të epokës sonë të krishterë, zbulohet tek ne si kohë e progresit të madh, kjo shfaqet gjithashtu si koha e kërcënimit shumëformësh për njeriun, për të cilën Kisha duhet t'ju flasë të gjithë njerëzve vullnetmirë, dhe rreth të cilës duhet të dialogojë gjithmonë me ta.

Situata e njeriut në botën bashkëkohore, në fakt, duket larg nga kërkesat objektive të rregullit moral, nga kërkesat e drejtësisë, dhe akoma më tepër nga dashuria shoqërore. Këtu nuk bëhet fjalë për atë që ka gjetur shprehje në mesazhin e parë të Krijuesit, drejtuar njeriut në momentin që i jepte tokën, për ta “sundojeni”<sup>100</sup>. Ky mesazh i parë është rikonfirmuar, në misterin e Shëlbimit, nga Krishti Zot. Kjo është e shprehur në Konkilin e II të Vatikanit në ato kapituj të bukur të mësimit të tij në lidhje me «privilegjin mbretëror» të njeriut, pra thirrja e tij për të marrë pjesë në misionin mbretëror –*munus regale*– të vetë Krishtit<sup>101</sup>. Kuptimi thelbësor i kësaj “mbretërie” dhe e këtij “zotërimi” të njeriut mbi botën e dukshme, që vetë Krijuesi ia ka caktuar si detyrë, konsiston \*në prioritetin e etikës ndaj teknikës, në vlerësimin e personit përmbi sendet, në superioritetin e shpirtit mbi gjerat materiale.

### **[Për të “qenurit” më shumë]**

Për këtë është e nevojshme të ndiqen me kujdes të gjitha fazat e progresit të sotëm: duhet, le të themi, të bëhet radiografia e secilës etapë, pikërisht nga ky këndvështrim. Bëhet fjalë për përparimin e njerëzve, dhe jo vetëm për shumimin e gjërave, të cilat njerëzit mund t’i përdorin. Bëhet fjalë –siç ka thënë një filozof bashkëkohor dhe siç e ka pohuar Koncili– jo “për të patur më shumë” por “për të qenë më shumë”<sup>102</sup>. Në fakt, ekziston tashmë një rrezik real dhe i përceptueshëm, që ndërsa zhvillohet jashtë mase dominimi nga ana e njeriut në botë mbi sendet, nga ky dominim i tij ai humbet fillin thelbësor, dhe në mënyra të ndryshme humaniteti i tij i nënshtrohet botës, dhe ai vetë shpesh bëhet objekt i manipulimit shumëformësh, edhe pse shpesh jo direkt i përceptueshëm, me anë të gjithë organizimit të jetës komunitare, me anë të sistemit të prodhimit, me anë të presionit të mjeteve të komunikimit shoqëror.

Njeriu nuk mund të heqë dorë nga vetja e tij, as në vendin që i përket në botën e dukshme: nuk mund të bëhet skllav i gjërave, skllav i sistemeve ekonomike, skllav i prodhimit, skllav i produkteve të veta. Një qytetërim me një profil plotësisht materialist e dënon njeriun ndaj një skllavërie të tillë, edhe pse ndonjëherë, pa dyshim, kjo është në kundërshtim me vetë qëllimet dhe premtimet e pionerëve të tij. Në rrënjët e përkujdesjes aktuale për njeriun qëndron patjetër ky problem. Këtu nuk bëhet fjalë vetëm t’i jepet një përgjigje abstrakte pyetjes: kush është njeriu; por bëhet fjalë për gjithë dinamizmin e jetës dhe të qytetërimit. Bëhet fjalë për domethënien e iniciativave të ndryshme të jetës së përditshme, dhe në të njejtën kohë, të premtimeve të programeve të shumta të qytetërimit, programe politike, ekonomike, shoqërore, shtetërore, dhe shumë të tjera.

### **[Rrëziqe të konsumizmit dhe nevoja për solidaritetin]**

Nëse guxojmë të pohojmë se situata e njeriut në botën bashkëkohore është larg nga kërkesat objektive të rregullit moral, largët nga kërkesat e drejtësisë, dhe akoma më tepër nga dashuria shoqërore, është sepse kjo konfirmohet nga faktet e njohura dhe nga krahasimet, të cilat shumë herë kanë pasur rezonancë të drejtpërdrejtë mbi faqet e shpalljeve papnore, këshillore, sinodale<sup>103</sup>. Situata e njeriut në epokën tonë nuk është sigurisht uniforme por e ndarë në mënyrë të shumëfishtë. Këto ndarje kanë shkaqet e tyre historike, por kanë edhe një rezonancë të tyre të fortë etike. Dhe në fakt, mjaft i njohur kuadri i qytetërimit konsumist, që konsiston në një farë hyrje të mirash të nevojshme për njeriun, në shoqëritë e tëra- dhe këtu bëhet fjalë pikërisht për shqëritë e pasura dhe shumë të zhvilluara- ndërsa shoqëritë e mbetura, të paktën shtresat e largëta të tyre, vuajnë nga uria, dhe shumë njerëz vdesin çdo ditë nga paushqyerja dhe uria. Me të njejtin hap ecën për disa edhe abuzimi i lirisë, që është i lidhur pikërisht me një qëndrim konsumist të pakontrolluar nga etika, dhe kjo kufizon në të njejtën kohë edhe lirinë e të tjerëve, pra të atyre që vuajnë mangësi të konsiderueshme dhe shtyhen drejt kushteve të mjerimit dhe varfërisë së mëtejshme.

Ky krahasim, i njohur gjerësisht, dhe kontrasti të cilit papët e shekullit tonë i janë referuar në dokumentat e magjisterit të tyre, më së fundi Gjoni XXIII si dhe Pali VI<sup>104</sup>, përfaqësojnë zhvillimin gjigand të shëmbëlltyrës biblike të njeriut të pasur dhe Lazrit skamnor<sup>105</sup>. Gjerësia e fenomenit vë në pikëpyetje strukturat dhe mekanizmat financiarë, monetarë, produktivë dhe tregtare, të cilat mbështeten në presione të ndryshme politike, mbajnë ekonominë botërore: ata shfaqen thuajse të paaftë si për të riasorbuar situatat e padrejta shoqërore, të trashëguara nga e shkuara, ashtu dhe për tju bërë ballë sfidave urgjente dhe kërkesave etike të së tashmes. Duke e nënshtuar njeriun nën tensionet e krijuara nga vetë ai, duke harxhuar burimet materiale dhe energjitike me një ritëm të përshpejtuar, duke kompromentuar ambjentin gjeofizik, këto struktura bëjnë që të shtrihen vazhdimisht zonat e varfërisë, dhe bashkë me këtë edhe ankthi, zhgënjimi dhe zemërimi<sup>106</sup>. Këtu gjendemi përpara një drame të madhe, që nuk mund të lërë asnjërin indiferent. Subjekti që, nga njëra anë përpiqet të nxjerrë maksimumin e përfitimit dhe ai që nga ana tjetër paguan haraçin e dëmeve dhe ofendimeve është gjithmonë njeriu. Drama bëhet akoma më e egër nga afrimiteti me shtresat shoqërore të privileguara dhe me vendet e pasura, që grumbullojnë të mirat materiale në shkallë të tepruar, dhe pasuria, shumë shpesh për abuzim, bëhet shkaku i sëmundjeve të ndryshme. Shtoni këtu dhe ethet e inflacionit dhe plagën e papunësisë: ja simptomat e tjera të këtij çrregullimi moral, që shfaqet në situatën botërore dhe që kërkon zgjidhje të guximshme dhe kreative, në përputhje me dinjitetin autentik të njeriut<sup>107</sup>. Një detyrë e tillë nuk është e pamundur të realizohet. Parimi i solidaritetit, në kuptimin e gjerë, duhet të frymëzojë hulumtimin efektiv të institucioneve dhe mekanizmave të përshtatshme: qoftë në fushën e

shërbimeve, ku ne duhet ta lejojmë veten të udhëhiqemi nga ligjet e një konkurrence të shëndetshme, qoftë dhe nëplanin e një rishpërndarje më të gjerë dhe më të menjëhershme të pasurive dhe kontrollit mbi ta, në mënyrë që popujt që po zhvillohen ekonomikisht jo vetëm të mund të kënaqin nevojat e veta thelbësore, por edhe të përhapen gradualisht dhe në mënyrë efektive.

Në këtë rrugë të vështirë, në rrugën e transformimit të domosdoshëm të strukturave të jetës ekonomike nuk do të jetë e lehtë për të përparuar, nëse nuk ndërhyr një konvertim i vërtetë i mendjes, vullnetit dhe zemrës. Kjo detyrë kërkon angazhimin e vendosur të njerëzve dhe popujve të lirë dhe mbështetës.

Liria shpesh ngatërrohet me instinktin e interesit individual ose kolektiv, ose edhe me instinktin e luftës dhe dominimit, pavarësisht nga ngjyrat ideologjike me të cilat është ngjyruar. Është e qartë se instinkte të tilla ekzistojnë dhe veprojnë, por nuk do të jetë e mundur ekonomia e vërtetë njerëzore, nëse këto instikte nuk supozohen, orientohen dhe dominohen nga forcat më të thella që gjenden te njeriu dhe që përcaktojnë kulturën e vërtetë të popujve.

### **[Rritja ekonomike nuk mund të jetë vlera supreme]**

Pikërisht nga këto burime duhet të lindë përpjekja, në të cilën të shprehet liria e vërtetë e njeriut e cila do të jetë në gjendje ta sigurojë atë edhe në fushën ekonomike. Zhvillimi ekonomik, me gjithçka që është pjesë e mënyrës së duhur të funksionimit të tij, duhet të programohet vazhdimisht dhe të zbatohet brenda një perspektive të zhvillimit universal dhe të bashkuar për çdo njeri dhe popull, siç thoshte në një mënyrë bindëse paraardhësi im Pali VI në "*Populorum Progressio*". Pa këtë, kategoria e vetme e "Progresi ekonomik" bëhet një kategori superiore që nënshton gjithë ekzistencën njerëzore ndaj nevojave të saj të pjesshme, mbyt njeriun, prish shoqëritë dhe përfundon i mbështjellë në tensionet dhe në ekzeset e veta.

Është e mundur të merret kjo detyrë: e dëshmojnë faktet dhe rezultatet që këtu është e vështirë të renditen në mënyrë analitike. Megjithatë, një gjë është e sigurt: në bazën e kësaj fushe gjigande është e nevojshme të krijojmë, të pranojmë dhe të thellojmë ndjenjën e përgjegjesisë morale që njeriu duhet të bëjë të tijën. Përsëri dhe përgjithmonë: njeriu. Për ne të krishterët një përgjegjësi e tillë bëhet veçanërisht e dukshme, kur kujtojmë - dhe ne duhet të kujtojmë gjithmonë - skenën e gjykimit të fundit, sipas fjalës së Krishtit të sjella në Ungjillin e Mateut<sup>108</sup>.

Kjo skenë eskatologjike duhet të "zbatohet" gjithmonë në historinë e njeriut, duhet të jetë gjithnjë "metër" i akteve njerëzore, si një skenë thelbësore e një shqyrtimi të ndërgjegjes për secilin dhe për të gjithë: "Sepse isha i uritur dhe nuk më dhatë të ha, isha i etshëm e nuk më dhatë të pi, isha shtegtarë e nuk më përbujtët, isha i zhveshur e nuk më veshët, i sëmurë dhe në burg e nuk erdhët tek unë"<sup>109</sup>. Këto fjalë marrin një ngarkesë më të madhe paralajmëruese, nëse mendojmë se në vend të bukës dhe ndihmës kulturore ndaj shteteve dhe kombeve të reja që po zgjohen për jetën e pavarur, ofrohen, ndonjëherë në bollëk, armë moderne dhe mjete shkatërrimi, të vendosura në shërbim të konflikteve të armatosura dhe luftimeve, të cilat nuk janë aq shumë një nevojë për të mbrojtur të drejtat e tyre të verteta dhe sovranitetin, por më tepër një formë fanatizmi, imperializmi, neokolonializmi i llojeve të ndryshme. Ne të gjithë e dimë se zonat e mjerimit dhe urisë, që ekzistojnë në globin tonë, mund të "mbillen" në një kohë të shkurtër, nëse investimet gjigante në armatim, të cilat përdoren për luftë dhe shkatërrim, të ishin shndërruar në investime për ushqime, që shërbejnë për jetën.

Ndoshta kjo konsideratë do të mbetet pjesërisht "abstrakte"; ndoshta i ofrojnë mundësinë njëri-tjetrit për të akuzuar "palët" reciprokisht, duke harruar secila fajet e veta. Ndoshta do provokojë akuza të reja kundra Kishës. Megjithatë, kjo e fundit, duke mos disponuar armë të tjera përveç të shpirtit, fjalës dhe dashurisë, nuk mund të heqë dorë të shpallë «Fjalën...në rast të volitshëm dhe të pavolitshëm»<sup>110</sup>. Prandaj, nuk pushon së luturi të dyja palët dhe së kërkuari të gjithëve në emër të Zotit edhe në emër të njeriut: Mos vrisni! Mos i përgaditni njerëzve shkatërrim dhe shfarosje! Mendoni për vëllezërit tuaj që vuajnë nga uria dhe mjerimi! Respektoni dinjetetin dhe lirinë e secilit!

## **17. Të drejtat e njeriut: «shkronjë» apo «shpirt»**

Shekulli ynë ka qenë deri tani një shekull fatkeqësish të mëdha për njeriun, shkatërrimesh të mëdha jo vetëm materiale, por edhe morale, madje sidomos morale. Sigurisht nuk është e thjeshtë të krahasosh nga

ky aspekt epoka dhe shekuj, sepse kjo varet edhe nga kriteret historike që ndryshojnë. Megjithatë, akoma pa bërë këto krahasime, duhet të konstatohet që deri tani ky shekull ka qenë një shekull në të cilin njerëzit i kanë përgatitur vetes së tyre shumë padrejtësi dhe vuajtje. Ky proces a është ndaluar përfundimisht? Sidoqoftë, nuk mund të mos kujtojmë, me vlerësim dhe me shpresë të thellë për të ardhmen, përpjekja e mrekullueshme e bërë për t'i dhënë jetë Organizatës së Kombeve të Bashkuara, një përpjeje që synon të përcaktojë dhe të stabilizojë të drejtat objektive dhe të pacënueshme të njeriut, duke i detyruar në mënyrë reciproke Shtetet-anëtare për një respektim rigoroz të tyre. Ky impenjim është pranuar dhe ratifikuar nga të gjitha Shtetet e kohës sonë, dhe kjo duhet të përbëjë një garanci që të drejtat e njeriut të bëhen në të gjithë botën, parimi themel i veprimit për të mirën e njeriut.

#### **[Paqja fryti i drejtësisë]**

Kisha nuk ka nevojë të konfirmojë se sa ngushtë është i lidhur ky problem me misionin e saj në botën bashkëkohore. Kjo në fakt, qëndron në bazat e paqes shoqërore dhe ndërkombëtare, siç kanë deklaruar në lidhje me këtë Gjoni XXIII, Koncili i II i Vatikanit dhe më pas Pali VI në dokumentat e detajuara. Në fund të fundit, paqja është thjesht respektimi i të drejtave të pacënueshme të njeriut –vepër e drejtësisë është paqja-, ndërsa lufta lind nga dhunimi i këtyre të drejtave dhe sjell me vete dhunime akoma më të rënda. Nëse të drejtat e njeriut çenohen në kohë paqeje, kjo bëhet shumë e dhimbshme, dhe nga pikëpamja e progresit, përfaqëson një fenomen të pakuptueshëm të luftës kundër njeriut, që nuk mund të bie dakord në asnjë mënyrë me çfarëdo lloj programi që vetëpërkufizohet si «humanist». E cili program shoqëror, ekonomik, politik, kulturor do të mund të hiqte dorë nga ky përkufizim? E kemi bindjen e thellë që nuk ka në botën e sotme ndonjë program i cili, madje edhe në platformën e ideologjive kundërshtarë rreth konceptimit të botës, që nuk e vendos gjithmonë në plan të parë njeriun.

Tani, nëse në dritën e këtyre premiseve, të drejtat e njeriut dhunohen në mënyra të ndryshme, nëse praktikisht jemi dëshmitar të fushat të përqëndrimit, të dhunës, të torturës, të terrorizmit dhe të diskriminimit të shumëfishtë, kjo duhet të jetë një pasojë e premiseve të tjera që minojnë dhe shkatërrojnë shpesh efikasitetin e premiseve humanistike të atyre programeve dhe sistemeve moderne. Atëherë imponohet domosdoshmërisht detyra për të nënshtruar këto programe në një rishikim të vazhdueshëm nga pikëpamja e të drejtave objektive dhe të pacënueshme të njeriut.

#### **[Të drejtat e njeriut]**

Deklarata e këtyre të drejtave, bashkë me institutin e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, me siguri nuk kishte si qëllim thjesht të shkëputej nga eksperiencat e tmerrshme të luftës së fundit botërore, por edhe që të krijonte një bazë për një rishikim të vazhdueshëm të programeve, të sistemeve, të regjimeve, pikërisht nga kjo pikëpamje e vetme dhe themelore, që është e mira e njeriut -le të themi i personit në komunitet- dhe që, si faktor themelor i të mirës së përbashkët, duhet të ndërtojë kriterin esencial të gjitha programeve, sistemeve, regjimeve. Në rast të kundërt, jeta njerëzore, edhe në kohë paqeje, është e dënuar me vuajtje të ndryshme dhe në të njëjtën kohë, bashkë me ato zhvillohen forma të dominimit, totalitarizmit, neokolonializmit, imperializmit, që kërcënojnë edhe bashkëjetesën mes kombeve. Në të vërtetë, është një fakt domethënës dhe i konfirmuar disa herë nga eksperiencat e historisë, sesi dhunimi i të drejtave të njeriut shkon paralel me dhunimin e të drejtave të kombit, me të cilin njeriu është i lidhur nga lidhje organike, ashtu si në një familje të madhe.

#### **[Totalitarizmat dhe kuptimi i vërtetë të Drejtave të njeriut]**

Që nga gjysma e parë e këtij shekulli, në periudhën në të cilën po zhvilloheshin totalitarizmat e ndryshme të Shtetit, të cilat –siç dihet- çuan në katastrofën e tmerrshme të luftës, Kisha e kishte përcaktuar qartësisht pozicionin e saj përballë këtyre regjimeve, që me sa duket vepronin për një të mirë superiore, që është e mira e Shtetit, ndërkohë që historia do kishte dëshmuar që ajo ishte thjesht e mira e një partie të caktuar, që identifikohet me Shtetin<sup>111</sup>. Realisht, ato regjime i detyruan të drejtat e qytetarëve, duke iu mohuar atyre njohjen e të drejtave të pacënueshme të njeriut që rreth gjysmës së shekullit tonë, kanë marrë formulimin e tyre në nivel ndërkombëtar. Në bashkëndarjen e gëzimit të kësaj fitoreje me gjithë njerëzit vullnetmirë, me gjithë njerëzit që e duan vërtetë drejtësinë dhe paqen, Kisha, e vetëdijshme që vetëm “shkronja” mund të vrasë, ndërsa vetëm “Shpirti jep jetë”<sup>112</sup>, duhet që bashkë me këta njerëz vullnetmirë, të pyesë vazhdimisht nëse kjo Deklaratë e të drejtave të njeriut dhe pranimi i “letrës” së tyre nënkuptojnë edhe realizimin e

“shpirtit” të tyre. Në fakt, rrjedhin frikëra të thella që shumë shpesh jemi akoma larg nga ky realizim, dhe që ndonjëherë shpirti i jetës shoqërore dhe publike gjendet në një kundërshti të dhimbshme me deklaratën “letër” të të drejtave të njeriut. Kjo gjendje, e rëndë për shoqëritë përkatëse, do bënte veçanërisht përgjegjës, përballë këtyre shoqërive dhe historisë së njeriut, ata që kontribuojnë për ta përcaktuar.

#### **[Pjesëmarrja në jetën publike]**

Kuptimi thelbësor i Shtetit, si komunitet politik, konsiston në faktin që shoqëria ose ata që e përbëjnë, populli, është sovran në fatin e tij. Ky kuptim nuk realizohet, nëse në vend të ushtrimit të pushtetit me pjesëmarrjen morale të shoqërisë dhe të popullit, ne asistojmë në vendosjen e pushtetit nga ana e një grupi të caktuar kundrejt të gjithë anëtarëve të tjerë të kësaj shoqërie. Këto gjëra janë esenciale në epokën tonë, në të cilën është rritur ndjeshëm vetëdija shoqërore e njerëzve, dhe bashkë me këtë edhe nevoja për një pjesëmarrje korrekte të qytetarëve në jetën politike të komunitetit, duke pasur parasysh kushtet reale të secilit popull dhe të forcës së nevojshme të autoritetit publik<sup>113</sup>.

Pra, këto janë probleme të një rëndësie primare nga pikëpamja e progresit të njeriut vetë dhe të zhvillimit global të humanitetit të tij.

#### **[E mira e përbashkët]**

Kisha ka mësuar gjithmonë detyrën për të vepruar për të mirën e përbashkët, dhe duke bërë kështu ka edukuar qytetarë të mirë në çdo shtet. Kisha, përveç kësaj ka mësuar gjithmonë që detyre themelore e pushtetit është përkujdesja për të mirën e përbashkët të shoqërisë; nga ku rrjedhin të drejtat e saj themelore. Pikërisht në emër të këtyre premtimeve të lidhura me rendin etik objektiv, të drejtat e pushtetit nuk mund të kuptohen në tjetër mënyrë përveç se në bazën e respektit të të drejtave objektive dhe të pacënueshme të njeriut. Ajo e mirë e përbashkët që autoriteti shërben në Shtet, realizohet plotësisht kur të gjithë qytetarët janë të sigurt për të drejtat e tyre. Pa këtë arrihet në një arratisje të shoqërisë, në kundërshtim të qytetarëve ndaj autoritetit, ose në një situatë shtypjeje, frike, dhune, terrorizmi, për të cilën kanë dhënë shembuj të shumtë totalitarizmat e shekullit tonë. Kështu parimi i të drejtave të njeriut prek thellësisht sektorin e drejtësisë shoqërore dhe bëhet matës për verifikimin e tij themelor në jetën e Organizimit politik.

#### **[Liria fetare]**

Mes këtyre të drejtave, me të drejtë numërohet e drejta e lirisë fetare, pranë të drejtës së lirisë së ndërgjegjes. Konkili i II i Vatikanit e ka konsideruar veçanërisht të nevojshme përpunimin e një deklarate më të gjërë mbi këtë temë. Dhe dokumenti që titullohet *Dignitatis Humanae*<sup>114</sup>, në të cilën është shprehur jo vetëm konceptimi teologjik i problemit, por edhe konceptimi nga pikëpamja e të drejtës natyrale, pra nga pozicioni «njerëzor i pastër», në bazë të atyre premtimeve të diktuara nga eksperiencia e vetë njeriut, nga arsyeja dhe nga kuptimi i dinjitetit të tij. Me siguri, kufizimi i lirisë fetare të personave dhe të komunitetit nuk është thjesht një eksperiencë e tyre e dhimbshme, por godet mbi të gjitha dinjitetin e vetë njeriut, pavarësisht nga feja e shpallur, apo nga koncepti që këta kanë për botën. Kufizimi i lirisë fetare dhe cënimi i saj bien në kundërshtim me dinjitetin e njeriut dhe me të drejtat e tij objektive. Dokumenti i sipërpërmendur i Konkilit, thotë me qartësi të mjaftueshme se çfarë është një kufizim dhe dhunim i tillë i lirisë fetare. Pa dyshim, në këtë rast gjendemi përballë një padrejtësie radikale për sa i përket asaj që është veçanërisht e thellë tek njeriu dhe asaj që është autentike njerëzore. Në fakt, edhe fenomeni i mosbesimit, mungesës së fesë dhe ateizmit, si fenomen njerëzor, kuptohet vetëm në lidhje me fenomenin e religjionit dhe të fesë. Prandaj, është e vështirë edhe nga pikëpamja «njerëzore e pastër» të pranosh një pozicion, sipas të cilit vetëm ateizmi ka të drejtën e qytetarisë në jetën politike dhe shoqërore, ndërsa njerëzit besimtarë, janë toleruar thjesht për parim, ose janë trajtuar si qytetarë të një kategorie inferiore, dhe madje –gjë që ka ndodhur– janë plotësisht të privuar nga të drejtat e qytetarisë.

Edhe pse shkurtimisht, është e nevojshme të trajtohet edhe kjo temë sepse edhe kjo hyn në kompleksin e situatave të njeriut në botën aktuale, sepse edhe kjo dëshmon sesa kjo situatë është e rënduar nga paragjykimet dhe padrejtësitë e llojeve të ndryshme. Nëse abstenojmë të hyjmë në veçantitë e kësaj fushe, në të cilën kemi një të drejtë dhe detyrë të veçantë për ta bërë, kjo është mbi të gjitha sepse, bashkë me gjithë ata që vuajnë torturat e diskriminimit dhe të persekutimit në emër të Zotit, udhëhiqemi nga feja në forcën shëlbuese të kryqit të Krishtit. Megjithatë, me anë të misionit tim, dëshiroj në emër të të gjithë besimtarëve të mbarë botës, t’iu drejtohem atyre nga të cilët, në një farë mënyre, varet organizimi i jetës

shoqërore dhe publike, duke iu kërkuar atyre me këmbëngulje, që të respektojnë të drejtat e fesë dhe të aktivitetit të Kishës. Nuk kërkohet asnjë privilegj, por respektimi i një të drejte elementare. Zbatimi i kësaj të drejte është një nga verifikimet themelore të progresit autentik të njeriut në çdo regjim, në çdo shoqëri, sistem apo ambient.

#### IV- Misioni i Kishës dhe fati i njeriut

##### 18. Kisha kujdeset për thirrjen e njeriut në Krishtin

Ky vështrim, i përmbledhur domosdoshmërisht në situatën e njeriut në botën bashkëkohore, na bën ta drejtojmë akoma më shumë mendimin dhe zemrën drejt Jezu Krishtit, në misterin e Shëlbimit, në të cilin problemi i njeriut është i gdhendur më një forcë të veçantë të së vërtetës dhe dashurisë. Nëse Krishti «është bashkuar në një farë mënyre me çdo njeri»<sup>115</sup>, Kisha, duke depërtuar në intimitetin e këtij misteri, me gjuhën e saj të pasur universale, jeton akoma më thellësisht natyrën dhe misionin e saj. Jo më kot apostulli flet për Korpin e Krishtit, që është Kisha<sup>116</sup>. Nëse ky Trup mistik i Krishtit është Populli i Zotit –siç thotë në vazhdim Koncili i II i Vatikanit , duke u bazuar në gjithë traditën biblike dhe të Kishës së hershme- kjo do të thotë që çdo njeri ka depërtuar në të nga ajo frymë e jetës që vjen nga Krishti. Në këtë mënyrë edhe kthimi kah njeriu, kah problemet e tij reale, kah shpresat dhe vuajtjet, fitimet dhe rënjet e tij, bën që Kisha vetë si trup, si organizëm, si njesi shoqërore, të përceptojë të njejtat impulse hyjnore, dritat dhe forcat e shpirtit që vijnë nga Krishti i kryqëzuar dhe i ringjallur, dhe pikërisht për këtë arsye ajo jeton jetën e saj. Kisha nuk ka jetë tjetër jashtë asaj që i dhuron Dhëndri dhe Zotëria i saj. Në fakt, pikërisht sepse Krishti në misterin e Shëlbimit të tij është i bashkuar me të, Kisha duhet të jetë e bashkuar më së miri me çdo njeri.

##### [Jeta e re në bashkim me Krishtin]

Ky bashkim i Krishtit me njeriun është një mister në vetvete, nga i cili lind “njeriu i ri”, i thirrur për të marrë pjesë në jetën e Hyjit<sup>117</sup>, i krijuar sërish në Krishtin në plotësinë e hirit dhe të së vërtetës<sup>118</sup>. Bashkimi i Krishtit me njeriun është forca dhe burimi i forcës sipas shprehjes së mprehtë të Sh. Gjonit, në prologun e Ungjillit të tij: «Fjala u dha zotësinë të bëhen bijtë e Hyjit»<sup>119</sup>. Kjo është forca që shndërron njeriun nga brenda, si parim i një jete të re që nuk zbehet dhe nuk kalon, por zgjat për jetën e pasosur<sup>120</sup>. Kjo jetë, e premtuar dhe e ofruar secilit njeri nga Ati në Jezu Krishtin, Birin e njëlindur dhe të përjetshëm, i mishëruar dhe i lindur «kur erdhi plotësia e kohës»<sup>121</sup>, nga Virgjëra Mari është përmbushja përfundimtare e thirrjes së njeriut. Është në një farë mënyre përmbushja e atij “fati” që i ka përgatitur Hyji nga përjetësia. Ky “fat hyjnor” bëhet udha, mbi të gjithë enigmat, të panjohurat, lëkundjet, kthesat e “fatit njerëzor” në botën e përkohshme. Nëse, në fakt, me gjithë pasurinë e jetës së përkohshme, për nevojë të pashmangshme, e gjitha kjo çon në kufirin e vdekjes dhe në qëllimin e shkatërrimit të trupit njerëzor, na shfaqet Krishti përtej këtij qëllimi: «Unë jam ringjallja dhe jeta; kush beson në mua..., nuk do të vdesë kurrë»<sup>122</sup>. Në Jezu Krishtin e kryqëzuar, të varrosur dhe pastaj të ringjallur, «na shkëlqeu shpresa e ngjalljes së lume, premtimi i pavdekësisë së ardhshme»<sup>123</sup>, në të cilën njeriu kalon përmes vdekjes së trupit, duke e bashkëndarë këtë domosdoshmëri me gjithë krijimin e dukshëm, nën të cilën është e nënshtruar lënda.

Ne synojmë dhe përpiqemi ta thellojmë gjithmonë e më shumë gjuhën e kësaj të vërtete, që Shëkbuesi i njeriut ka përmbledhur në një fjali: «Shpirti është ai që jep jetën, mishi nuk vlen asgjë»<sup>124</sup>. Këto fjalë, pavarësisht nga paraqitja, shprehin pohimin më të lartë të njeriut: pohimin e trupit, të cilit Shpirti i jep jetë! Kisha jeton këto realitete, jeton me këtë të vërtetë mbi njeriun, që e lejon të kalojë kufijtë e së përkohshmes dhe njëkohësisht të mendojë me dashuri dhe përkujdesje të veçantë për gjithë atë që, në dimensionet e kësaj së përkohshmeje, ndikon në jetën e njeriut, në jetën e shpirtit njerëzor, në të cilin shprehet ai shqetësim shumëvjeçar, sipas fjalëve të Sh. Agostinit: «Na ke bërë o Zot për ty dhe nuk është e qetë zemra jonë, derisa të pushojë në ty»<sup>125</sup>. Në këtë shqetësim kreativ rreh dhe pulson atë që është më thellësisht njerëzore: kërkimi i së vërtetës, nevoja e pangopur për të mirën, uria për lirinë, nostalgjia për të bukurën, zëri i ndërjegjes.

##### [Thesari i Kishës: Shpirti i premtuar]

Kisha, duke kërkuar ta shohë njeriun pothuajse «me sytë e vetë Krishtit», është gjithmonë e më e vetëdijshme që ruan një thesar shumë të madh, të cilin nuk lejohet ta humbasësh, por duhet ta rrisë vazhdimisht. Në fakt, Zoti Jezus ka thënë: «kush nuk mbledh me mua, ai shkapërderdh»<sup>126</sup>. Ky thesar i njerëzimit, i pasuruar nga misteri i pashprehshëm i bijësisë hyjnore<sup>127</sup>, i hirit në «bijësinë në shpirt»<sup>128</sup> në njëtëlindurin Birin e Hyjit, nëpërmjet të cilit i themi Hyjit “Abbà! O Atë”<sup>129</sup>, është një forcë e fuqishme që bashkon Kishën veçanërisht nga brenda dhe i jep kuptim gjithë aktivitetit të saj. Nga kjo forcë Kisha bashkohet me Shpirtin e Krishtin, me atë Shpirt të Shenjt që Shëlbuesi kishte premtuar, që komunikon vazhdimisht dhe prejardhja e të cilit u zbulua ditën e Rrëshajës, zgjat përgjithmonë. Kështu zbulohen tek njerëzit forcat e Shpirtit<sup>130</sup>, dhuratat e Shpirtit<sup>131</sup>, frytet e Shpirtit Shenjt<sup>132</sup>. Dhe Kisha e kohës sonë duket se e përsërit me entuziazëm gjithmonë e më të madh dhe me insistim të shenjtë: «Eja o Shpirti Shenjt!». Eja! Eja! Njollat hiq dangat pastro, n’shpirtëra tanë hirit rigo, varrët e mëkatit na i shëro. Çka është brishtë këndshëm lako, çka është ftohtë- me flakë rretho, çka është t’shtrembët- ëmbël drejto<sup>133</sup>.

Kjo lutje për Shpirtin, që synon pikërisht për të marrë Shpirtin, është përgjigja e të gjithë “materializmave” të epokës sonë. Këto bënë të lindin shumë forma të pangopshmërisë së zemrës njerëzore. Kjo lutje ndjehet në vende të ndryshme dhe duket që jep fryte edhe në mënyra të ndryshme. A mund të thuhet që me këtë lutje Kisha nuk është e vetme? Po, mund të thuhet, sepse “nevoja” për atë që është shpirtërore është shprehur edhe nga persona që ndodhen jashtë kufirit të dukshëm të Kishës<sup>134</sup>. A nuk është konfirmuar kjo nga e vërteta mbi Kishën, e vënë në dukje më shumë mprehtësi nga Koncili i fundit në Kushtetutën dogmatike *Lumen Gentium*, aty ku thotë që Kisha është «sakrament, apo shenjë, apo instrument i bashkimit intim me Hyjin dhe të bashkimit me gjithë njerëzimin»<sup>135</sup>? Kjo thirrje e Shpirtit dhe për Shpirtin nuk është tjetër përveç se një hyrje në dimensionin e plotë të misterit të Shëlbimit, në të cilin Krishti, i bashkuar me Atin dhe me çdo njeri, na e transmeton vazhdimisht atë \*Shpirt që ngulit tek ne ndjenjat e Birit dhe na orienton drejt Atit<sup>136</sup>. Prandaj Kisha e epokës sonë –epokë veçanërisht e uritur për Shpirt, sepse është e uritur për drejtësi, paqë, dashuri, mirësi, forcë, përgjegjësi, dinjitet njerëzor– duhet të përqëndrohet dhe të bashkohet rreth këtij misteri, duke gjetur në këtë dritën dhe forcën e domosdoshme për misionin e saj. Nëse në të vërtetë- siç është thënë më përpara- njeriu është rruga e jetës së përditshme të Kishës është e nevojshme që vetë Kisha të jetë e vetëdijshme për dinjitetin e adoptimit hyjnor që njeriu zotëron, në Krishtin, për hir të Shpirtit Shenjt<sup>137</sup>, dhe për destinacionin e hirit dhe të lavdit<sup>138</sup>. Duke reflektuar përsëri mbi gjithë këtë, duke e pranuar me fe gjithmonë e më të vetëdijshme dhe më dashuri gjithmonë e më të vendosur, Kisha bëhet në të njëjtën kohë më e përshtatshme për shpërbimin ndaj njeriut, të cilin Krishti Zot e thërret, kur thotë: «Biri i njeriut... që s’erdhi për të qenë shërbyer, por për të shërbyer»<sup>139</sup>. Kisha e ushtron këtë mister të saj, duke marrë pjesë në “misionin e trefishtë” që është pikërisht misioni i mësuesit dhe i Shëlbuesit të saj.

Kjo doktrinë, e mbështetur në themelin e saj biblik, është vënë në dukje nga Koncili i II i Vatikanit , me avantazh të madh për jetën e Kishës.

Në fakt, kur bëhemi të vetëdijshëm për pjesëmarrjen në misionin e trefishtë të Krishtit, në “zyrën e trefishtë” –priftërore, profetike dhe mbretërore<sup>140</sup>, bëhemi edhe më të vetëdijshëm për atë të cilës duhet t’i shërbejë e gjithë Kisha, si shoqëri dhe komunitet i Popullit të Zotit mbi tokë, duke kuptuar gjithashtu se cila duhet të jetë pjesëmarrja e secilit pej nesh në këtë mision dhe shërbim.

## 19. Misioni profetik i Kishës: përgjegjësia për të Vërtetën

### [Besnikëria ndaj së Vërtetës]

Kështu, në dritën e doktrinës së shenjtë të Koncilit të Vatikanit II, Kisha shfaqet para nesh si subjekti shoqëror i përgjegjësisë të së vërtetës hyjnore. Me emocion të thellë dëgjojmë vetë Krishtin kur thotë: «E fjala që po dëgjoni, nuk është imja, por është e Atij që më dërgoi, -e Atit»<sup>141</sup>. A nuk paralajmërohet në këtë pohim të Mësuesit tonë ajo përgjegjësi për të vërtetën e zbuluar, që është “veçori” e vetë Hyjit, nëse Ai, “Bir i njëlindur” që jeton «një natyrë me Atin»<sup>142</sup>, kur e transmeton si profet dhe mësues, ndjen nevojën të theksojë që vepron në besnikëri të plotë në burimin e tij Hyjnor? E njëjta besnikëri duhet të jetë një cilësi përbërëse e fesë së Kishës, si kur e mëson ashtu edhe kur e pretendon atë. Feja, si virtyt specifik i

mbinatyrshëm i krijuar në shpirtin njerëzor, na bën pjesëmarrës të ndërgjigjes së Zotit, si përgjigje e fjalës së tij të zbuluar. Prandaj kërkohet që Kisha kur profetizon dhe mëson fenë, të jetë përkrahëse e madhe e së vërtetës hyjnore<sup>143</sup>, dhe ta përkthejë atë në sjellje jetësore të respektit të kushtëzuar për arsyen<sup>144</sup>. Krishti vetë, me qëllim që t'i sigurojë besnikërinë të vërtetës hyjnore, i ka premtuar Kishës kujdesin e veçantë të Shpirtit të së vërtetës, iu ka dhënë atyre dhuratën e pagabueshmërisë<sup>145</sup>, të cilëve ju ka besuar mandatin për të trasmetuar këtë të vërtetë dhe për ta mësuar<sup>146</sup> –siç e kishte përcaktuar tashmë shumë qartë Koncili i Vatikanit I<sup>147</sup>, dhe në vazhdim ka përsëritur Koncili i II i Vatikanit <sup>148</sup>, -dhe ka pajisur gjithashtu të gjithë Popullin e Zotit me një domethënje të veçantë feje<sup>149</sup>.

Si rrjedhojë, jemi bërë pjesëmarrës të këtij misioni të Krishtit-profet dhe në forcën e këtij misioni, po shërbejmë të vërtetën hyjnore në Kishë bashkë me Atë. Përgjegjësia për këtë të vërtetë do të thotë të duash dhe të kërkosh kuptimin më të saktë, me qëllim që të bëjë më të afërt me ne dhe me të tjerët në gjithë forcën e saj shpëtuese, në lavdinë e saj, në thellësinë dhe thjeshtësinë e saj. Kjo dashuri dhe ky frymëzim për ta kuptuar të vërtetën duhet të ecin sëbashku, siç konfirmojnë historitë e Shenjtërve të Kishës. Ata ishin më të ndriçuar nga drita autentike, që ndriçon të vërtetën hyjnore dhe afron realitetin e Hyjit, sepse i afroreshin kësaj të vërtete me nderim dhe dashuri: dashuri kryesisht për Krishtin, Fjala e gjallë e së vërtetës hyjnore si dhe dashuria për shprehjen e tij njerëzore në Ungjill, në traditë, në teologji. Edhe sot janë të nevojshme një kuptim dhe një interpretim i tillë i Fjalës hyjnore; është e nevojshme një teologji e tillë. Teologjia ka pasur dhe vazhdon të ketë një rëndësi të madhe, që Kisha, Populli i Zotit, të mundet në mënyrë krijuese dhe të frytshme të marrë pjesë në misionin profetik të Krishtit. Prandaj, teologët si shërbyes të së vërtetës hyjnore, i dedikojnë studimet dhe punët e tyre një kuptimi gjithmonë e më depërtues të kësaj, nuk mund ta humbin kurrë nga sytë domethënien e shërbimit të tyre në Kishë, i përmbledhur në termin «intellectus fidei». Ky koncept funksionon, le të themi, me ritëm bilateral, sipas shprehjes së Shën Agustinit: «intellege, ut credas; crede, ut intellegas»<sup>150</sup>, dhe funksionon në mënyrë korrekte kur ata kërkojnë të shërbenjë Magjisterin, e besuar Ipeshkvinjve, të bashkuar nga lidhja e bashkësisë hierarkike me Pasardhësin e Pjetrit, kur vihen në shërbim të kujdesit të tyre në mësimdhënie dhe në kujdesin pastoral, ashtu sikur vihen në shërbim të angazhimeve apostolike të gjithë Popullit të Zotit.

#### **[Misioni i teologëve]**

Si në epokat paraardhëse, ashtu edhe sot –e ndoshta akoma më shumë– teologët dhe të gjithë njerëzit e shkencës në Kishë janë të thirrur të bashkojnë fenë me shkencën dhe dijen, për të kontribuar në një ndërfutje të tyre reciproke, siç e lexojmë në lutjen liturgjike për kujtimin e Shën Albertit, doktor i Kishës. Sot ky impenjim është angazhuar jashtëzakonisht për shkak të progresit të shkencës njerëzore, të metodave të saj dhe fitoreve në njohurinë e botës dhe të njeriut. Kjo ka të bëjë si me shkencat ekzakto, ashtu dhe me ato humane, si filozofia, lidhjet e ngushta të së cilës me teologjinë janë kujtuar edhe nga Koncili i II i Vatikanit <sup>151</sup>.

Në këtë fushë të njohurisë njerëzore, që vazhdimisht zgjerohet dhe ndryshon, edhe feja duhet të thellohet në mënyrë konstante, duke manifestuar dimensionin e misterit të zbuluar dhe të tentojë të kuptojë të vërtetën, që burimin e vetëm suprem e ka në Hyjin. Nëse është e lejueshme -dhe këtë duhet ta urojmë- që ajo punë e madhe për t'u zhvilluar në këtë kuptim, merr në konsideratë një farë pluralizmi të metodave, gjithsesi një punë e tillë nuk mund të largohet nga njesia themelore e mëimit të Fesë dhe të Moralit, që është qëllimi i saj. Prandaj është e domosdoshme një bashkëpunim i ngushtë i teologjisë me Magjisterin. Çdo teolog duhet të jetë veçanërisht i vetëdijshëm për atë që vetë Krishti ka shprehur, kur ka thënë: «E fjala që po dëgjoni, nuk është imja, por është e Atij, që më dërgoi, -e Atit»<sup>152</sup>.

Askush nuk mund ta bëjë teologjinë sikur të ishte thujse një koleksion i thjeshtë i koncepteve personale; por secili duhet të jetë i vetëdijshëm të qëndrojë në bashkim me atë mision për të mësuar të vërtetën, për të cilin është përgjegjëse Kisha.

#### **[Misioni i barinjve – katekeza]**

Pjesëmarrja në misionin profetik të Krishtit formëson jetën e gjithë Kishës, në dimensionin e saj themelor. Një pjesëmarrje e veçantë në këtë mision iu përket Barinjve të Kishës, të cilët mësojnë, dhe vazhdimisht në mënyra të ndryshme, shpallin dhe transmetojnë doktrinën e fesë dhe të moralit të krishterë. Ky mësim, si



nën aspektin misionar ashtu edhe nën aspektin e zakonshëm, kontribuon për të mbledhur popullin e Hyjit rreth Krishtit, përgadit për pjesëmarrjen në Eukaristi, tregon rrugët e jetës sakramentale.

Sinodi i Ipeshkvinjëve në 1977, i ka dedikuar vëmendjen e tij të veçantë katekizmit në botën bashkëkohore, dhe fruti i pjekur i diskutimeve, eksperiencave dhe sugjerimeve të tij, do të gjejë së shpejti shprehjen e tij – në përputhje me propozimin e pjesëmarrësve në Sinod – në dokumentin e posaçëm papnor.

Katekeza përbën sigurisht një formë të përvitshme dhe themelore të aktivitetit të Kishës, në të cilën shfaqet karizma e saj profetike: dëshmia dhe mësimdhënia eci me të njëjtin hap. E megjithëse këtu flitet në radhë të parë për meshtarët është e pamundur të mos kujtojmë edhe numrin e madh të fetarëve dhe të fetareve, që i përkushtohen aktivitetit katekistik për dashuri të Mësuesit hyjnor. Dhe së fundi, do të ishte e vështirë të mos përmendim laikët e shumtë, që në këtë aktivitet gjejnë shprehjen e fesë dhe të përgjegjësisë së tyre apostolike. Për më tepër, është gjithnjë e nevojshme të provohet se format e ndryshme të katekezës dhe fushat e saj të ndryshme – duke filluar nga forma themelore që është katekeza “familjare”, pra katekeza e prindërve ndaj fëmijëve të tyre – dëshmon pjesëmarrjen universale të të gjithë Popullit të Zotit në misionin profetik të vetë Krishtit. Është e nevojshme që në varësi të këtij fakti, përgjegjësia e Kishës për të vërtetën hyjnore të jetë gjithmonë e më shumë, në mënyra të ndryshme, e bashkëndarë nga të gjithë. E çfarë të themi këtu për specialistët e disiplinave të ndryshme, për përfaqësuesit e shkencave natyrore dhe letrare, për mjekët, juristët, për njerëzit e artit dhe të teknikës, për mësuesit e gradave dhe specializimeve të ndryshme?

**[Të gjithë besimtarët janë të përfshirë]**

Të gjithë ata – si pjesëtar të Popullit të Zotit – kanë pjesën e tyre në misionin profetik të Krishtit, në shërbimin e tyre në të vërtetën hyjnore, edhe me qëndrimin e ndershëm përballë së vërtetës, në çfarëdo fushe ajo bën pjesë, ndërkohë që edukojnë te tjerët për të vërtetën dhe iu mësojnë atyre të rriten në dashuri dhe në drejtësi. Kështu pra, sensi i përgjegjësisë për të vërtetën është një nga pikat e takimit kryesore të Kishës me çdo njeri, dhe është gjithashtu një nga nevojat kryesore, që përcaktojnë thirrjen e njeriut në komunitetin e Kishës. Kisha e kohëve tona, e udhëhequr nga sensi i përgjegjësisë për të vërtetën, duhet të ngulmojë në besnikërinë e natyrës së vet, në të cilën është i bazuar misioni profetik që vjen nga vetë Krishti: «*Sikurse më dërgoi mua Ati, ashtu unë po ju dërgoj ju... Merrni Shpirtin Shenjt*»<sup>153</sup>.

## **20. Misioni priftëror: Eukaristia dhe pendesa**

Në misterin e Shëlbimit, pra të veprës shpëtimprurëse e kryer nga Jezu Krishti, Kisha merr pjesë në Ungjillin e Mësuesit të saj jo vetëm me anë të besnikërisë ndaj Fjalës dhe të shërbimit ndaj së vërtetës, por merr pjesë edhe me anë të nënshtrimit, plot me shpresë dhe me dashuri, në fuqinë e veprimit shëlbues, që Ai e ka shprehur dhe e ka përmbledhur në formë sakramentale, sidomos në Eukaristi<sup>154</sup>.

**[Eukaristia: përkujtimi i flisë së Krishtit të miratuar nga Ati]**

Kjo është qendra dhe maja e të gjithë jetës saktamentale, përmes të cilës çdo i krishterë merr forcën shëlbuese të Shëlbimit, duke filluar nga misteri i Pagëzimit, në të cilin jemi zhytur me vdekjen e Krishtit, për t'u bërë pjesë e Ringjalljes së tij<sup>155</sup>, siç mëson apostulli. Në dritën e kësaj doktrine, bëhet akoma më e qartë arsyea për të cilën gjithë jeta saktamentale e Kishës dhe e çdo të krishteri arrin majën dhe plotësinë e saj pikërisht në Eukaristi. Në këtë Sakrament, në fakt, rinovohet vazhdimisht, për dëshirë të Krishtit, misteri i sakrificës, që Ai e bëri për veten tek Ati mbi altarin e Kryqit: sakrificë që Ati e pranoi, duke e rikthyer këtë dhurim total të Birit të tij, që u bë «i dëgjueshëm deri në vdekje»<sup>156</sup>, me dhurimin e tij atëror, pra me dhuratën e jetës së re të pavdekshme në ringjallje, sepse Ati është burimi dhe dhënësi i parë i jetës që nga fillimi. Kjo jetë e re që përfshin lavdinë trupore të Krishtit të kryqëzuar, është bërë shenjë efikase e dhuratës së re dhënë njerëzimit, dhuratë që është Shpirti i Shenjtë, me anë të së cilit jeta hyjnore, që Ati ka në vetvete dhe që ja dha Birit të tij<sup>157</sup>, i komunikohet të gjithë njerëzve që janë të bashkuar me Krishtin.

Eukaristia është Sakramenti më persosur i këtij bashkimi. Duke celebruar dhe duke marrë pjesë në Eukaristi, ne bashkohemi me Krishtin tokësor dhe qiellor, dhe ndërhyjnë për ne tek Ati<sup>158</sup>; por bashkohemi gjithmonë me anë të aktit shëlbues të saktificës së tij, me anë të së cilit Ai na ka shëlbuar, kështu që kemi qenë «blerë me çmim të lartë»<sup>159</sup>. «Çmimi i lartë» i shëlbimit tonë dëshmon vlerën që Hyji vetë i atribuon njeriut, dëshmon dinjitetin tonë në Krishtin. Duke u bërë në fakt «bijtë e Hyjit»<sup>160</sup>, bij të adoptimit<sup>161</sup>, në

ngjashmërinë e tij ne bëhemi në të njëjtën kohë «mbretëri dhe priftërinj», do përfitojmë «meshtari mbretërore»<sup>162</sup>, pra marrim pjesë në këtë kthim unik dhe të pakthyeshem të njeriut dhe të botës së Atit që Ai, Bir i përjetshëm<sup>163</sup>, njeri i vërtetë, e bëri njëherë e përgjithmonë. Eukaristia është Sakramenti, në të cilin shprehet më plotësisht qenia jonë e re, në të cilën Krishti vetë, vazhdimisht dhe gjithmonë në mënyrë të re, «dëshmon» në Shpirtin Shenjt shpirtit tonë<sup>164</sup>, që secili prej nesh si pjesëmarrës në misterin e Shëlbimit, ka qasje në frytet e pajtimit birnor me Hyjin<sup>165</sup>, të cilin Ai vetë e kishte zbatuar dhe e zbaton mes nesh me anë të mbarështimit të Kishës.

#### **[Eukaristia ndërton Kishën]**

Është e vërtetë esenciale, jo vetëm doktrinale por edhe ekzistenciale, që Eukaristia ndërton Kishën<sup>166</sup>, dhe e ndërton si komunitet autentik i Popullit të Zotit, si asamble e besimtarëve, i shënuar nga vetë karakteri i njesisë, në të cilën ishin pjesëmarrës apostujt dhe dishepujt e parë të Hyjit. Eukaristia e ndërton sërisht këtë këtë komunitet dhe njesi; gjithmonë e ndërton dhe e rigjeneron mbi bazën e sakrificës së vetë Krishtit, sepse përkujton vdekjen e tij në Kryq<sup>167</sup>, me çmimin e së cilës kemi qenë shëlbuar nga Ai. Prandaj, në Eukaristi prekim, mund të themi, misterin e Korpit dhe të Gjakut të Zotit, siç dëshmojnë fjalët në momentin e vendosjes, të cilat në sajë të saj, janë bërë fjalët e celebrimit të përvitshëm të Eukaristisë nga ana e të thirrurve në këtë mister në Kishë.

Kisha jeton nga Eukaristia, jetojnë nga plotësia e këtij Sakramenti, përmbajtja dhe domethënia e tij e mrekullueshme kanë gjetur shpesh shprehjen e tyre në Magjisterin e Kishës, nga kohët më të lashta deri në ditët tona<sup>168</sup>. Megjithatë, mund të themi me siguri që kjo mësimdhënie – e mbështetur nga mprehtësia e teologëve, nga njërëziti më fë të thellë dhe më lutje, nga asketët dhe mistikët, në gjithë besnikërinë e tyre ndaj misterit eukaristik – mbetet thuajse në prag, duke mos qenë në gjendje të kuptojë dhe të përkthejë në fjalë atë që Eukaristia është në gjithë plotësinë e saj, atë që ajo shpreh dhe atë që zbatohet në të.

Në fakt, ajo është Sakramenti i pashprehur! Angazhimi esencial, dhe sidomos hiri dhe burimi i dukshëm i forcës së mbinatyreshme të Kishës si Populli i Zotit, është ngulmimi dhe progresi i vazhdueshëm në jetën eukaristike, në mëshirën eukaristike, është zhvillimi shpirtëror në klimën e Eukaristisë. Aq më tepër pra, nuk është e lejueshme as në mendime, as në jetë, as në veprime t'i hiqet këtij Sakramenti, vërtet të shenjtë, dimensionin e tij i plotë dhe domethënia e tij esenciale. Ky është në të njëjtën kohë Sakramenti-Sakrificë, Sakramenti-Bashkim, Sakramenti-Prani. Megjithëse është e vërtetë që Eukaristia ka qenë gjithmonë dhe duhet të jetë akoma zbulesa dhe krenimi më i thellë i vëllazërizë njerëzore të dishepujve dhe rrëfyesve të Krishtit, nuk mund të trajtohet thjesht si një “rastësi” për ta manifestuar këtë vëllazëri. Në krenimin e Sakramentit të Korpit dhe të Gjakut të Zotit, është e nevojshme të respektohet dimensionin e plotë i misterit hyjnor, kuptimi i plotë i kësaj shenje sakramentale, në të cilin Krishti, vërtet i pranishëm, merret, shpirti mbushet me Hir, dhe ne na jepet premtimi i lavdisë së ardhshme<sup>169</sup>. Nga këtu rrjedh detyra për një respektim rigoroz të normave liturgjike dhe të gjithë asaj që dëshmon kultin komunitar të bërë nga vetë Hyji, aq më tepër në këtë shenje sakramentale, Ai na beson në me një besim të pakufi, sikur nuk e merr fare në konsideratë dobësinë tonë njerëzore, padenjësini tonë, zakonet tona, “rutinën” apo edhe mundësinë për fyerje. Të gjithë në Kishë, por sidomos Ipeshkvinjtë dhe Priftërinjtë, duhet të jenë vigjilent që ky Sakrament i dashurisë të jetë në qendër të jetës së Popullit të Zotit, që nëpërmjet të gjitha manifestimeve të kultit të duhur, të bëhet në mënyrë që ta bëjë Krishtin “dashuri për dashuri”, që Ai të bëhet vërtet «jeta e shpirtave tanë»<sup>170</sup>. Nga ana tjetër nuk mund të harrojmë kurrë këto fjalë të shën Palit: «secili më së pari ta shqyrtojë mirë veten e veç atëherë të hajë prej kësaj Buke e të pijë prej këtij Kelku»<sup>171</sup>.

#### **[Lidhje mes Eukaristisë dhe Pendesës]**

Kjo ftësë e Apostullit tregon, në mënyrë jo të drejtpërdrejtë të paktën, lidhjen e ngushtë mes Eukaristisë dhe Pendesës. Në fakt, nëse fjala e parë e mësimin të Krishtit, fjalia e parë e Ungjillit Lajmit të Mirë ishte «Kthehuni e besoni Ungjillit» (metanoëite)<sup>172</sup>, Sakramenti i Pasionit, i kryqit dhe i Ringjalljes duket se e përforcon dhe e konsolidon në mënyrë krejt të veçantë këtë ftesë të shpirtërave tanë. Eukaristia dhe Pendesa bëhen kështu në një farë kuptimi, një dimension i dyfishtë dhe jashtëzakonisht i lidhur me jetën autentike sipas shpirtit të Ungjillit, jeta e krishterë e vërtetë. Krishti, që fton në banketin eukaristik, është po ai Krisht që na nxit drejt Pendesës, që përsërit «Kthehuni»<sup>173</sup>. Pa këtë përpjekje konstante dhe gjithmonë të rinovuar për kthim, pjesëmarrja në Eukaristi do të ishte e mangët në efikasitetin e plotë shëlbues, do të ishte më i

pakët, ose do të dobësohej ajo gatishmëri e veçantë për t'i bërë Hyjit sakrificë shpirtërore<sup>174</sup>, në të cilën shprehet në mënyrë esenciale dhe universale pjesëmarrja jonë në priftërinë e Krishtit. Në Krishtin në fakt, priftëria është e bashkuar me sakrificën e tij, me dhurimin e tij tek Ati; dhe ky dhurim, pikërisht sepse është i pakufi, bën që të lindë në ne –njerëz të nënshtruar ndaj kufizimeve të shumta- nevoja për tu drejtuar nga Hyji në formë gjithmonë e më të pjekur dhe me një kthim konstant, gjithmonë e më të thellë.

Në vitet e fundit është bërë shumë për të vënë në dukje –në përputhje me traditën e vjetër të Kishës – aspektin komunitar të pendesës e mbi të gjitha të Sakramentit të Pendesës në praktikën e Kishës. Këto iniciativa janë të dobishme dhe me siguri shërbejnë për ta pasuruar praktikën e pendesës në Kishën bashkëkohore. Por nuk mund të harrojmë kthimi është një akt i brendshëm i një thellësie të veçantë, në të cilin njeriu nuk mund të zevëndësohet nga të tjerët, nuk mund të bëjë vetën të “zëvendësohet” nga komuniteti. Edhe pse bashkësia vëllazërore e besimtarëve, pjesëmarrës në kremtimin e pendesës, përfiton shumë nga akti i kthimit personal, megjithëse në fund të fundit, është e nevojshme që në këtë veprim të shpallet vetë individi, me gjithë thellësinë e ndërgjgjes së tij, me gjithë ndjënjen e tij të fajit dhe të besimit në Hyjin, duke u vënë përballë Tij, si Psalmisti, për të rrëfyer: «kam bërë çështë keq para teje»<sup>175</sup>.

Pra Kisha, duke vëzhguar me besnikëri praktikën shumëshekullore të sakramentit të Pendesës –praktika e rrëfimit individual, bashkë me aktin personal të dhimbjes, dhe me qëllim për tu korigjuar dhe për tu kënaqur– mbron të drejtën e veçantë të shpirtit njerëzor. Është e drejta e një takimi më personal të njeriut me Krishtin e kryqëzuar që fal, me Krishtin që thotë, nëpërmjet shërbimit të sakramentit të Pajtit: «*të janë falur mëkatet*»<sup>176</sup>; «*Shko, por mbas tashit mos mëkato më!*»<sup>177</sup>. Siç është e dukshme, kjo është në të njëjtën kohë e drejta e vetë Krishtit ndaj çdo njeriu që ai ka shëlbuar. Është e drejta e takimit me secilin nga ne në atë moment- çelësi i jetës së shpirtit, që është ajo e kthimit dhe e faljes. Kisha, duke mbrojtur sakramentin e Pendesës, pohon shprehimisht fenë e saj në misterin e Shëlbimit, si realitet i gjallë dhe gjallërues, që korrespondon me të vërtetën e brendshme të njeriut, korrespondon me fajësinë njerëzore dhe me dëshirat e ndërgjgjes njerëzore. «Lum ata që kanë uri e etje për drejtësi sepse do të ngihen!»<sup>178</sup>. Sakramenti i Pendesës është mjeti për ta ngopur njeriun me atë drejtësi, që vjen nga vetë Shëlbuesi.

Në Kishë që sidomos në kohët tona, mblidhet thjesht rreth eukaristisë, dhe dëshiron që komuniteti autentik eukaristik të bëhet shenjë e unitetit të të gjithë të krishterëve, unitet që po maturohet gradualisht, duhet të jetë e gjallë nevoja e pendesës, si në aspektin e saj sakramental<sup>179</sup>, ashtu si edhe në atë që lidhet me pendesën si virtut. Ky aspekti i dytë është shprehur nga Pali VI në Kushtetutën Apostolike *Paenitemini*<sup>180</sup>. Një nga detyrat e Kishës është të vërë në praktikë mësimin që ajo përmban; bëhet fjalë për argumentin që duhet të thellohet patjetër akoma nga ne në reflektimin e përbashkët, është bërë objekt i shumë diskutimeve të mëtejshme, në shpirtin e kolegialitetit pastoral, duke respektuar traditat e ndryshme që kanë të bëjnë me këtë dhe rrethanat e ndryshme të jetës së njerëzve të kohës tonë. Megjithatë, është e sigurt që Kisha e Ardhjes së re, Kisha që përgaditet vazhdimisht për ardhjen e re të Zotit, duhet të jetë Kisha e Eukaristisë dhe e Pendesës. Vetëm nën këtë profil shpirtëror të vitalitetit dhe të aktivitetit të saj, është Kisha e misionit hyjnor, Kisha *in statu missionis*, kështu siç na e ka zbuluar Koncili i II i Vatikanit .

## 21. Misioni mbretëror: Thirrja e krishterë për shërbim

Koncili i II i Vatikanit , duke ndërtuar nga të njëjtat themele imazhin e Kishës si Popull i Zotit –me anë të treguesit të misionit të trefishtë të vetë Krishti, në të cilin duke marrë pjesë bëhemi vërtet Populli i Zotit- ka vënë në dukje edhe këtë karakteristikë të thirrjes së krishterë, që mund të përkufizohet “mbretërore”. Për të prezantuar të gjithë pasurië e doktrinës së Koncilit, këtu do të ishte e nevojshme t'i referohemi kapitujve dhe pagrafëve të shumtë të Kushtetutës *Lumen Gentium*, si dhe shumë dokumentave të tjerë këshillëtar. Në mes të gjithë kësaj pasurie, duket se del një element i ri: pjesëmarrja në misionin mbretëror të Krishtit, pra fakti i zbulimit në vetvete dhe tek të tjerët atë dinjitet të veçantë të thirrjes sonë, që mund të përkufizohet “privilegj mbretëror”. Ky dinjitet shprehet në gatishmërinë për të shërbyer, sipas shembullit të Krishtit, që «s'erdhi për të qenë shërbyer, por për të shërbyer»<sup>181</sup>. Nëse pra, në dritën e këtij qëndrimi të Krishtit mund të “mbretërohet” me të vërtetë vetëm duke “shërbyer”, në të njëjtën kohë “të shërbyerit” kërkon një pjekuri të tillë shpirtërore që duhet ta përkufizojmë pikërisht “mbretërore”. Që të mund t'iu shërbesh të tjerëve

denjësisht dhe në mënyrë efikase, duhet ditur të sundosh vetveten, duhen zotëruar virtytet që e bëjnë të mundur këtë dominim. Pjesëmarrja jonë në misionin mbretëror të Krishtit –pikërisht në “misionin e tij mbretëror” (*munus*) –është e lidhur ngushtë me çdo sferë morale, të krishterë dhe njerëzore gjithashtu.

### **[Populli i Zotit: Hierarkia, Laikët, Rregulltarët, të gjithë në shërbim]**

Koncili i II i Vatikanit, duke prezantuar kuadrin e plotë të Popullit të Zotit, duke na kujtuar se çfarë vendi kanë në këtë jo vetëm meshtarët por edhe laikët, jo vetëm përfaqësuesit e Hierarkisë, por edhe ata e ato të Institutet të jetës së kushtuar, nuk e ka zbritur këtë imazh vetëm nga një premtim sociologjik. Kisha, si shoqëri njerëzore, mund të përkufizohet dhe të ekzaminohet patjetër sipas kategorive, të cilat përdorin shkencat përballë çdo shoqërie njerëzore. Por këto kategori nuk janë të mjaftueshme. Për gjithë komunitetin e Popullit të Zotit dhe për secilin nga anëtarët e tij, nuk bëhet fjalë thjesht për një “anëtarësim shoqëror” specifik, por më tepër është e rëndësishme, për secilin dhe për të gjithë një “thirrje” e veçantë. Kisha në fakt, si Popull i Zotit –sipas mësimit të sipërpërmendur të Shën Palit dhe të përsëritur në mënyrë të admirueshme nga Piu XII –është edhe «Trupi mistik i Krishtit»<sup>182</sup>. Anëtarësimi në këtë trup rrjedh nga një thirrje e veçantë, e bashkuar më veprimin shpëtimprurës të hirit. Pra nëse duam të kemi parasysh këtë komunitet të Popullit të Zotit, kaq e gjerë dhe jashtëzakonisht të diferencuara, duhet para së gjithash të shohim Krishtin, që në një farë mënyrë i thotë çdo pjesëtar të këtij komuniteti: «Eja mbas meje!»<sup>183</sup>. Ky është komuniteti i dishepujve, secili prej të cilëve, në mënyra të ndryshme, ndonjëherë shumë i vetëdijshëm dhe koherent, ndonjëherë pak i vetëdijshëm dhe shumë jo koherent, ndjek Krishtin. Në këtë manifestohet edhe profili thellësisht “personal” dhe dimensionin i kësaj shoqërie, e cila –pavarësisht të gjitha mangësive të jetës komunitare, në kuptimin njerëzor të fjalës –është një komunitet pikërisht për faktin që të gjithë e ndërtojnë sëbashku me Krishtin, sepse mbajnë në shpirtin e tyre shenjë e pandryshueshme të atij që është i krishterë.

### **[Besnikëria ndaj thirrjes]**

Po ai Koncil ka përdorur një vëmendje krejt të veçantë, për të demonstruar se në çfarë mënyre ky komunitet “ontologjik” i dishepujve dhe i dëshmitarëve [*confessores*] duhet të bëhet gjithmonë e më shumë, edhe “njerzërisht”, një komunitet i vetëdijshëm për jetën dhe aktivitetin e vet. Iniciativat e Koncilit në këtë fushë kanë gjetur vazhdimësinë e tyre në iniciativat e tjera të shumta me karakter sinodal, apostolik dhe organizativ. Por duhet të kemi gjithmonë parasysh të vërtetën që çdo iniciativë së pari shërben për rinovimin e vërtetë të Kishës, dhe ndërkaq kontribuon për të sjellë dritën autentike që është Krishti<sup>184</sup>, përderisa bazohet mbi ndërgjegjësimin e përshtatshëm të thirrjes dhe të përgjegjësisë për këtë hir të vetëm, unik dhe të papërsëritshëm, e anë të së cilit çdo i krishterë në komunitetin e Popullit të Zotit ndërton Korpin e Krishtit. Ky parim, i cili është rregulli kryesor i të gjitha praktikave të krishtera –praktika apostolike dhe baritore, praktika e jetës së brendshme dhe asaj shoqërore– duhet të zbatohet, në përpjesëtim të drejtë, me të gjithë njerëzit dhe gjithësecilit prej tyre. Edhe Papa, ashtu si çdo ipeshkëv, duhet ta aplikojë për vete. Këtij parimi duhet t’i jenë besnik meshtarët, rregulltarët dhe rregullaret. Në bazë të saj duhet të ndërtojnë jetën e tyre bashkëshortët, prindërit, gratë dhe burrat me kushte dhe profesione të ndryshme, duke filluar nga ata që zënë në shoqëri detyrat më të larta dhe duke përfunduar me ata që kryejnë punët më të thjeshta. Ky është pikërisht parimi i atij “shërbimi mbretëror” që i imponon secilit prej nesh, duke ndjekur shembullin e Krishtit, detyrën për t’i kërkuar pikërisht vetvetes atë për të cilën jemi të thirrur, ku –për t’iu përgjigjur thirrjes– jemi të detyruar personalisht, me hirin e Hyjit. Kjo besnikëri ndaj thirrjes e marrë nga Hyji, nëpërmjet Krishtit, merr mbi vete atë përgjegjësi solidale për Kishën, për të cilën Koncili II i Vatikanit don të edukojë të gjithë të krishterët. Në Kishë, në fakt, si në bashkësinë e Popullit të Hyjit, e udhëhequr nga veprimi i Shpirtit të Shenjtë, secili ka «dhuratën e vet», siç na mëson Shën Pali<sup>185</sup>. Kjo “dhuratë”, duke qënë një thirrje personale dhe një formë pjesëmarrjeje në veprën shpëtimtare të Kishës, u shërben njëlloj të tjerëve, ndërton Kishën dhe bashkësitë vëllazërore në sferat e larmishme të ekzistencës njerëzore mbi tokë. Besnikëria ndaj thirrjes, domethënë gatishmëria e qëndrueshme për “shërbimin mbretëror”, ka një rëndësi të veçantë për këtë ndërtim të shumëfishtë, mbi të gjitha për atë që ka të bëjë me detyrat më angazhuese, që kanë ndikim të madh në jetën e të afërmit tonë dhe të shoqërisë në tërësi. Për besnikëri ndaj thirrjes së tyre duhet të dallohen bashkëshortët, siç kërkohet nga natyra e pathyeshme e institucionit sakramental të martesës. Për një besnikëri të ngjashme ndaj thirrjes personale duhet të dallohen meshtarët, duke pritur

karakterin e pashlyeshëm që sakramenti i Urdhërit vulos në shpirtrat e tyre . duke marrë këtë sakrament, ne në Kishën Latine angazhohemi me vetëdije dhe me liri të jetojmë në beqari, dhe për këtë secili nga ne duhet të bëjë të pamundurën, me hirin e Hyjit, për të qenë mirënjohës për këtë dhuratë dhe besnik ndaj lidhjes së pranuar përgjithmonë. Kjo nuk është ndryshe nga bashkëshortët, që me të gjithë forcën e tyre përpiqen të ruajnë bashkimin martesor, duke ndërtuar me këtë dëshmi të dashurisë bashkësinë familjare dhe duke edukuar gjeneratat e reja të njerëzve, të aftë edhe ata të shugurojnë gjithë jetën e tyre thirrjes personale, domethënë, atij "shërbimi mbretëror", për të cilin shembulli dhe modeli më i bukur na janë ofruar nga Jezu Krishti. Kisha e tij, që ne të gjithë ndërtojmë, është "për njerëzit" në kuptim që, duke u bazuar në shembullin e Krishtit<sup>186</sup> dhe duke bashkëpunuar me hirin që Ai ka fituar, mund të arrijmë atë "mbretërim", dhe kështu të realizojmë një njerëzim të pjekur në secilin prej nesh. Njerëzim i pjekur domethënë përdorim të plotë të dhuratës së lirisë, që e kemi marrë nga Krijuesi, në momentin në të cilin ai ka thirrur në ekzistencë njeriun të bërë në imazhin dhe përngjasimin e vet. Kjo dhuratë gjen realizimin e saj të plotë në dhurimin, pa rezerva, të të gjithë personit njerëzor, me shpirt të dashurisë nusërore të Krishtit dhe, me Krishtin, të gjithë atyre, që Ai dërgon burra ose gra, që Atij janë plotësisht të shuguruar sipas këshillave ungujllore. Ja ideali i jetës rregulltare, pranuar nga Urdhërat dhe Kongregatat, qoftë antike, qoftë të kohëve të fundit, dhe nga Institutet shekullore.

### **[Të lirohet liria me dashurinë]**

Në kohët tona, nganjëherë konsiderohet, gabimisht, që liria është si qëllim në vetvete, që çdo njeri është i lirë kur e përdor atë siç dëshiron, dhe për këtë është e nevojshme të shtrihet në jetën e individëve dhe të shoqërisë. Ndërsa liria, është një dhuratë e madhe, vetëm atëherë kur dimë ta përdorim me vetëdije për gjithë atë që është e mira e vërtetë. Krishti na mëson që përdorimi i mirë i lirisë është bamirësia, që realizohet në dhuratë dhe në shërbim. Për këtë "liri Krishti na liroi"<sup>187</sup> dhe na liron gjithmonë. Nga këtu, Kisha e nxjerr frymëzimin e pandërprerë, ftesën dhe impulsin e misionit të saj dhe në shërbim të saj në mes të të gjithë njerëzve. E vërteta e plotë mbi lirinë e njeriut është thellësisht e gdhendur në misterin e Shëlbimit. Kisha i shërben me të vërtetë njerëzimit, kur mbron këtë të vërtetë me kujdesje të palodhur, me dashuri të zjarrtë, me angazhim të pjekur, dhe kur në gjithë bashkësinë e saj, nëpërmjet besnikërisë ndaj thirrjes së çdo të krishteri, e transmeton dhe e konkretizon në jetën njerëzore. Në këtë mënyrë konfirmohet ajo që kemi përmendur më parë, domethënë se njeriu është dhe bëhet gjithmonë "rruga" e jetës së përditëshme të Kishës.

## **22. Maria, Nëna e besimit tonë**

Kur, pra, në fillim të papatit të ri i drejtoj Shëlbuesit të njeriut mendimin tim dhe zemrën time, dëshiroj në këtë mënyrë të hyj dhe të depërtoj në ritmin më të thellë të jetës së Kishës. Nëse, në fakt, Kisha jeton jetën e saj, kjo ndodh sepse e nxjerr nga Krishti, i cili dëshiron gjithmonë vetëm një gjë, domethënë që ta kemi jetën dhe ta kemi me plotësi<sup>188</sup>. Kjo plotësi jete, që është në Të, është njëkohësisht për njeriun. Prandaj, Kisha, duke iu bashkuar të gjitha pasurive të misterit të Shëlbimit, bëhet Kishë e njerëzve të gjallë, të gjallë sepse të gjallëruar nga brenda për virtyt të "Shpirtit të së vërtetës"<sup>189</sup> sepse dashuria e Hyjit u ndikua në zemrat tona me anë të Shpirtit Shenjt<sup>190</sup>. Qëllimi i çdo shërbimi në Kishë, qoftë apostolik, baritor, meshtarak, ipeshkvnor, është të mbajë këtë lidhje dinamike të misterit të Shëlbimit me çdo njeri.

Nëse jemi të vetëdijshëm për këtë detyrë, atëherë na duket të kuptojmë më mirë çfarë do të thotë të themi se Kisha është nënë<sup>191</sup>, dhe akoma çfarë do të thotë që Kisha gjithmonë dhe, në mënyrë të veçantë, në kohët tona ka nevojë për një Nënë. Kemi një mirënjohje të veçantë për Etërit e Koncilit të II të Vatikanit, të cilët kanë shprehur këtë të vërtetë në Kushtetutën e *Lumen Gentium* me doktrinën e pasur mariologjike që përmbante në të <sup>192</sup>. Sepse Pali VI, i frymëzuar nga kjo doktrinë, ka shpallur Nënë e Krishtit "Nëna e Kishës"<sup>193</sup> dhe ky emërim ka gjetur një jehonë të gjërë, qoftë e lejueshme gjithashtu edhe për pasardhësin e tij të padenjë t'i drejtohet Marisë, si Nënë e Kishës, në fund të këtyre konsideratave, që ishte e përshtatshme të kryhej në fillim të shërbimit papnor. Maria është Nëna e Kishës, sepse, në virtyt të zgjedhjes së pashprehshme të të njëjtit Atë të përjetshëm<sup>194</sup> dhe nën veprimin e veçantë të Shpirtit të dashurisë<sup>195</sup>. Ajo i ka dhënë jetën njerëzore Birit të Hyjit, "për të cilin dhe prej të cilit është çdo gjë"<sup>196</sup> dhe nga ku i gjithë

Populli i Hyjit merr hirin dhe dinjitetin e zgjedhjes. Biri i tij deshi në mënyrë të qartë ta zgjerojë amësinë e Nënës së tij –dhe ta zgjerojë në mënyrë lehtësisht të arritshme për të gjithë shpirtrat e zemrat– duke i treguar si bir, nga lartësia e Kryqit, nxënësin e tij të përzgjedhur<sup>197</sup>. Shpirti Shenjtë i sugjeroi të qëndronte edhe Ajo, pas ngjitjes së Zotit tonë, në Çenakull e mbledhur në lutje dhe në pritje, së bashku me Apostujt deri në ditën e Rrëshajëve, ku duhej në mënyrë të dukshme të lindte Kisha, duke dalë nga errësira<sup>198</sup>. Dhe në vazhdim të gjitha brezitë e dishepujve dhe gjithë atyre që dëshmojnë dhe duan Krishtin –kështu si Gjoni apostull–. Prej asaj ore nxënësi e mori me vete këtë Nënë<sup>199</sup>, e cila në këtë mënyrë, që nga fillimi, domethënë, që nga momenti i Lajmërimit, është futur në historinë e shpëtimit dhe në misionin e Kishës. Prandaj, të gjithë ne, të cilët formojmë brezin e sotëm të dishepujve të Krishtit, dëshirojmë t'i bashkohemi Asaj në mënyrë të veçantë. E bëjmë me gjithë lidhjen ndaj traditës së lashtë dhe, në të njëjtën kohë, me respekt të plotë dhe dashuri për anëtarët e të gjitha Bashkësive të krishtera.

E bëjmë të nxitur nga domosdoshmëria e thellë e besimit, e shpresës dhe e dashurisë. Nëse, në fakt, në këtë fazë të vështirë dhe të përgjegjshme të historisë së Kishës dhe të njerëzimit ndjejmë një nevojë të veçantë t'i drejtohemi Krishtit, që është Zot i Kishës së tij dhe Zot i historisë së njeriut në forcë të misterit të Shëlbimit, ne besojmë se askush tjetër përveç Marisë nuk di të na ndihmojë të hyjmë në dimensionin hyjnor dhe njerëzor të këtij misteri. Askush si Maria nuk qe futur në të nga vetë Hyji. Në këtë konsiston karakteri i jashtëzakonshëm i hirit të amësisë hyjnore. Nuk është vetëm unik dhe i papërsëritshëm dinjiteti i kësaj amësie në historinë e njerëzimit, por unik edhe për thellësinë dhe rrezet e veprimit është pjesëmarrja e Marisë, për shkak të së njëjtës amësi, planit hyjnor të shpëtimit të njeriut, nëpërmjet misterit të Shëlbimit.

Ky mister është formuar, mund të themi, nën zemrën e virgjërës së Nazaretit, kur ka shqiptuar “*fiat-in*” e saj. Nga ai moment kjo zemër virgjërore dhe së bashku amnore, nën veprimin e veçantë të Shpirtit Shenjtë, ndjek gjithmonë punën e Birit të saj dhe shkon drejt gjithë atyre, që Krishti ka përqaftuar dhe përqafton vazhdimisht në dashurinë e tij të pashterrshme. Dhe, për këtë, kjo zemër duhet të jetë edhe amnisht e pashterrshme. Karakteristika e kësaj dashurie amnore, që Nëna e Hyjit vendos në misterin e Shëlbimit dhe në jetën e Kishës, gjen shprehjen e saj në afërsinë e vet me njeriun dhe me të gjitha ngjarjet e tij. Në këtë konsiston misteri i Nënës. Kisha, që e shikon me dashuri dhe shpresë të veçantë, dëshiron t'i përshtatet këtij misteri në mënyrë gjithnjë e më të thellë. Në të, në fakt, Kisha njeh dhe rrugën e jetës së saj të përditshme, që është çdo njeri.

Dashuria e amshuar e Atit, manifestuar në historinë e njerëzimit nëpërmjet Birit që Ati dha “*kështu që, secili që beson në të, të mos birret, por të ketë jetën e pasosur*”<sup>200</sup>, një dashuri e tillë i afrohet çdonjërit prej nesh nëpërmjet kësaj Nëne dhe fiton në një farë mënyre shenja më të besushme dhe të arritshme për secilin njeri. Si rezultat i kësaj, Maria duhet të gjendet në të gjitha rrugët e jetës së përditshme të Kishës. Përmes pranisë së saj amnore, Kisha është e sigurtë që jeton me të vërtetë jetën e Mësuesit dhe Zotit të saj, që jeton misterin e Shëlbimit në gjithë gjallërinë e thellë dhe të plotë të saj. Gjithashtu e njëjta Kishë, që ka rrënjët e saja në fusha të shumta dhe të larmishme të jetës së të gjithë njerëzimit bashkëkohorë, fiton gjithashtu sigurinë dhe, do të thuhej, eksperiencën e të qenurit afër njeriut, të qenurit Kisha e “saj”: Kisha e popullit të Hyjit.

#### [*Nevoja për lutje*]

Përballë këtyre detyrave, që ngrihen përgjatë rrugëve të Kishës, përgjatë këtyre rrugëve, që Papa Pali VI na ka treguar në Enciklikën e Pontifikatit të tij, ne, të vetëdijshëm për nevojën absolute të të gjitha këtyre udhëve dhe, në të njëjtën kohë, të vështirësive që mbi to mblidhen, aq më shumë dëgjojmë nevojën për një lidhje të fortë me Krishtin. Tingëllojnë në ne si një jehonë tingëlluese, fjalët që ai tha: “*Pa mua s'mund të bëni asgjë*”<sup>201</sup>. Nuk dëgjojmë vetëm nevojën, por edhe domosdoshmërinë kategorike për një lutje të madhe, intensive, në rritje të mbarë Kishës. Vetëm lutja mund të bëjë që këto detyra të mëdha dhe vështirësi që pasojnë njëra-tjetrën mos të bëhen burim krizash, por rast dhe pothuajse themel i arritjeve gjithnjë e më të pjekura në rrugën e Popullit të Hyjit drejt Tokës së Premtuar, në këtë fazë të historisë që po i afrohet fundit të Mijëvjeçarit të dytë. Prandaj, duke mbaruar këtë meditim me një ftesë të ngrohtë e të përvujtë lutjeje, dëshiroj qëndrueshmëri në këtë lutje të bashkuar me Marinë, Nënë e Jezusit<sup>202</sup>, ashtu siç qëndronin Apostujt dhe dishepujt e Zotit, pas Ngjitjes së tij, në dhomën e sipërme të Jeruzalemit<sup>203</sup>. Veçanarisht i drejtohem Marisë, nënës qiellore të Kishës, në mënyrë që të denjohet në këtë lutje të Ardhjes së re të

njerëzimit të qëndrojë me ne, që formojmë Kishën, domethënë Trupin mistik të Birit të tij të vetëm. Unë shpresoj që, falë kësaj lutjeje, mund të marrim Shpirtin Shenjtë që zbret mbi ne<sup>204</sup> dhe të bëhemi në këtë mënyrë dëshmitarë të Krishtit “deri në skajin e botës”<sup>205</sup>, si ata që dolën nga Çenakulli i Jerusalemit në ditën e Rrëshajëve.

Me Bekimin tim Apostolik.

Dhënë Romës, në Shën Pjetër, me 4 mars, të dielen e parë të Krezhmëve, të vitit 1979, Papati i parë.

GJON PALI II

- <sup>1</sup> *Gjn* 1, 14.  
<sup>2</sup> *Gjn* 3, 16.  
<sup>3</sup> *Heb* 1, 1 vv.  
<sup>4</sup> Lajmi i Gëzueshëm i Vigjiljes së Pashkëve.  
<sup>5</sup> *Gjn* 16, 7.  
<sup>6</sup> *Gjn* 15, 26 vv.  
<sup>7</sup> *Gjn* 16, 13.  
<sup>8</sup> *Krh. Zb* 2, 7.  
<sup>9</sup> Kusht. dogm. mbi Kishën *Lumen gentium*, 1: AAS 57 (1965) 5.  
<sup>10</sup> *Ef* 3, 8.  
<sup>11</sup> *Gjn* 14, 24.  
<sup>12</sup> Pali PP. VI, let. enc. *Ecclesiam Suam* : AAS 56 (1964) 650 vv.  
<sup>13</sup> *Mt* 11, 29.  
<sup>14</sup> Duhet të kujtohen këtu dokumentet që i përkasin Papatit të Palit VI, e për disa prej tyre foli ai vetë në fjalimin mbajtur gjatë Meshës, ne solemnitetin e Sh. Apostuj Pjetër e Palë në 1978: Let. Enc. *Ecclesiam Suam*: AAS 56 (1964) 609-659; Ep. Apost. *Investigabiles Divitias Christi*: AAS 57 (1965) 298-301; Let. Enc. *Mysterium Fidei*: AAS 57 (1965) 753-774; Let. Enc. *Sacerdotalis Caelibatus*: AAS 59 (1967) 657-697; *Solemnis Professio Fidei*: AAS 60 (1968) 433445; Let. Enc. *Humanae Vitae*: AAS 60 (1968) 481-503; Nxitje Apost. *Quinque iam anni*: AAS 63 (1971) 97-106; Nxitje Apost. *Paterna cum Benevolentia*: AAS 67 (1975) 5-23; Nxitje Apost. *Gaudete in Domino*: AAS 67 (1975) 289-322; Nxitje Apost. *Evangelii Nuntiandi*: AAS 68 (1976) 576.  
<sup>15</sup> *Mt* 13, 52.  
<sup>16</sup> *1 Tim* 2,4.  
<sup>17</sup> Pali PP. VI, Nxitje Apost. *Evangelii Nuntiandi*: AAS 68 (1976) 5-76.  
<sup>18</sup> *Gjn* 17, 21; *krh. ibid.* 17, 11.22 vv.; 10, 16; *Lk* 9, 49 vv. 54.  
<sup>19</sup> *1 Kor* 15, 10.  
<sup>20</sup> *Krh. Konc. Ecum. Vat. I*, Kusht. dogm. mbi fenë katolike *Dei Filius*, cann. III *De fide*, n. 6: *Conciliorum Oecumenicorum Decreta*, Ed. Institutit për Shkencat Fetare, Bologna 1973 3, p. 811.  
<sup>21</sup> *Is* 9, 6.  
<sup>22</sup> *Gjn* 21, 15.  
<sup>23</sup> *Lk* 22, 32.  
<sup>24</sup> *Gjn* 6, 68; *krh. Vap* 4, 8-12.  
<sup>25</sup> *Krh. Ef* 1, 10.22; 4, 25; *Kol* 1, 18.  
<sup>26</sup> *1 Kor* 8, 6; *krh. Kol* 1, 17.  
<sup>27</sup> *Gjn* 14, 6.  
<sup>28</sup> *Gjn* 11, 25.  
<sup>29</sup> *Krh. Gjn* 14, 9.  
<sup>30</sup> *Krh. Gjn* 16, 7.  
<sup>31</sup> *Krh. Gjn* 16, 7.13.  
<sup>32</sup> *Kol* 2, 3.  
<sup>33</sup> *Krh. Rm* 12, 5; *1 Kor* 6, 15; 10, 17; 12, 12.27; *Ef* 1, 23; 2, 16; 4, 4; *Kol* 1, 24; 3, 15.  
<sup>34</sup> *Konc. Ekum. Vat. II*, Kusht. dogm. Mbi Kishën *Lumen gentium*, 1: AAS 57 (1965) 5.  
<sup>35</sup> *Mt* 16, 16.  
<sup>36</sup> *Krh. Litanitë e Zembrës së Krishtit*.  
<sup>37</sup> *1 Kor* 2, 2.  
<sup>38</sup> *Krh. Zan* 1 *passim*.  
<sup>39</sup> *Krh. Zan* 1, 26-30.  
<sup>40</sup> *Rm* 8, 20; *krh. ibid.*, 8, 19-22; *Konc. Ekum. Vat. II*, Kusht. bar. mbi Kishën në botën bashkëkohore *Gaudium et spes*, 2; 13: AAS 58 (1966) 1026; 1034 vv.  
<sup>41</sup> *Gjn* 3, 16.  
<sup>42</sup> *Krh. Rm* 5, 12-21.  
<sup>43</sup> *Rm* 8, 22.  
<sup>44</sup> *Rm* 8, 19.  
<sup>45</sup> *Rm* 8, 22.  
<sup>46</sup> *Rm* 8, 19.  
<sup>47</sup> Kusht. bar. mbi Kishën në botën bashkëkohore *Gaudium et spes*, 22: AAS 58 (1966) 1042 vv.  
<sup>48</sup> *Krh. Rm* 5, 11; *Kol* 1, 20.  
<sup>49</sup> *Sal* 8, 6.  
<sup>50</sup> *Krh. Zan* 1, 26.  
<sup>51</sup> *Krh. Zan* 3, 6-13.  
<sup>52</sup> *Krh. IV Prece eucaristica*.  
<sup>53</sup> *Krh. Konc. Ekum. Vat. II*, Kusht. bar. mbi Kishën në botën bashkëkohore *Gaudium et spes*, 37: AAS 58 (1966) 1054 vv.; Kusht. dogm. mbi Kishën *Lumen gentium*, 48: AAS 57 (1965) 53 vv.  
<sup>54</sup> *Krh. Rm* 8, 29 vv.; *Ef* 1, 8.  
<sup>55</sup> *Krh. Gjn* 16, 13.  
<sup>56</sup> *Krh. 1 Sel* 5, 24.  
<sup>57</sup> *2 Kor* 5, 21; *krh. Gal* 3, 13.  
<sup>58</sup> *1 Gjn* 4, 8.16.  
<sup>59</sup> *Krh. Rm* 8, 20.  
<sup>60</sup> *Krh. Lk* 15, 11-32.  
<sup>61</sup> *Rm* 8, 19.  
<sup>62</sup> *Krh. Rm* 8, 18.  
<sup>63</sup> *Krh. S. Tommaso*, *Summa Theol.* III, q. 46, a. 1, ad 3.  
<sup>64</sup> *Gal* 3, 28.  
<sup>65</sup> Lajmi i Gëzueshëm i Vigjiljes së Pashkëve  
<sup>66</sup> *Krh. Gjn* 3, 16.  
<sup>67</sup> *Krh. S. Giustino*, I *Apologia* , 46, 1-4; II *Apologia* , 7 (8), 1-4; 10, 1-3; 13, 3-4: *Florilegium Patristicum II*, Bonn 19112 81, 125, 129, 133; *Klementi Aleksandrinasi*, *Stromata I*, 19, 91.94: *S. Ch.* 30, 117 vv.; 119 vv.; *Konc. Ekum. Vat. II*, Dekr. , aktiviteti misionarë i Kishës *Ad gentes*, 11: AAS 58 (1966) 960; Kusht. dogm. mbi Kishën *Lumen gentium*, 17: AAS 57 (1965) 21.  
<sup>68</sup> *Krh. Dekr. mbi marrëdhënjet e Kishës me fetë jo të krishtera Nostra Aetate*, 3-4: AAS 58 (1966) 741-743.  
<sup>69</sup> *Kol* 1, 26.  
<sup>70</sup> *Mt* 11, 12.  
<sup>71</sup> *Lk* 16, 8.  
<sup>72</sup> *Ef* 3, 8.  
<sup>73</sup> *Krh. n. 1 vv.*; AAS 58 (1966) 740 vv.  
<sup>74</sup> *Krh. Vap* 17, 22-31.  
<sup>75</sup> *Gjn* 2, 25.  
<sup>76</sup> *Gjn* 3, 8.  
<sup>77</sup> *Krh. AAS* 58 (1966) 929-946.  
<sup>78</sup> *Krh. Gjn* 14, 26.  
<sup>79</sup> Pali PP. VI, Nxitje Ap. *Evangelii Nuntiandi*, 6: AAS 68 (1976) 9.  
<sup>80</sup> *Gjn* 7, 16.  
<sup>81</sup> *Krh. AAS* 58 (1966) 936 vv.  
<sup>82</sup> *Gjn* 8, 32.  
<sup>83</sup> *Gjn* 18, 37.  
<sup>84</sup> *Krh. Gjn* 4, 23.  
<sup>85</sup> *Gjn* 4, 23 vv.  
<sup>86</sup> *Krh. Let. Enc. Ecclesiam Suam*: AAS 56 (1964) 609-659.



- <sup>87</sup> Kusht. bar. mbi Kishën në botën bashkëkohore *Gaudium et spes*, 22: AAS 58 (1966) 1042.
- <sup>88</sup> Krh. *Gjn* 14, 1 vv.
- <sup>89</sup> Kusht. bar. mbi Kishën në botën bashkëkohore *Gaudium et spes*, 91: AAS 58 (1966) 1113.
- <sup>90</sup> *Ibid.*, 38: l. c., p. 1056.
- <sup>91</sup> *Ibid.*, 76: l. c., p. 1099.
- <sup>92</sup> Krh. *Zan* 1, 27.
- <sup>93</sup> Kusht. bar. mbi Kishën në botën bashkëkohore *Gaudium et spes*, 24: AAS 58 (1966) 1045.
- <sup>94</sup> *Zan* 1, 28.
- <sup>95</sup> Kusht. bar. mbi Kishën në botën bashkëkohore *Gaudium et spes*, 10: AAS 58 (1966) 1032.
- <sup>96</sup> *Ibid.*, 10: l. c., p. 1033.
- <sup>97</sup> Krh. *ibid.*, 38: l. c., p. 1056; Pali PP. VI, Lett. Enc. *Populorum Progressio*, 21: AAS 59 (1967) 267 v.
- <sup>98</sup> Krh. *Zan* 1, 28.
- <sup>99</sup> Krh. *Zan* 1-2.
- <sup>100</sup> *Zan* 1, 28; krh. Konc. Ekum. Vat. II, Dekr. Mbi mjetët e komunikimit social *Inter Mirifica*, 6: AAS 56 (1964) 147; Kusht. bar. mbi Kishën në botën bashkëkohore *Gaudium et spes*, 74, 78: AAS 58 (1966) 1095 v., 1101 v.
- <sup>101</sup> Krh. Kusht. dogm. mbi Kishën *Lumen gentium*, 10, 36: AAS 57 (1965) 14 v.; 41 v.
- <sup>102</sup> Krh. Kusht. bar. mbi Kishën në botën bashkëkohore *Gaudium et spes*, 35: AAS 58 (1966) 1035; Pali PP. VI, Fjalim Trupit Diplomatik, 7 janarë 1965: AAS 57 (1965) 232; Let. Enc. *Populorum Progressio*, 14: AAS 59 (1967) 264.
- <sup>103</sup> Krh. Piu PP. XII, Radiomesazhë për 50<sup>e</sup> vjetorin e Encikl. «*Rerum Novarum*» të papës Luani XIII (1 qershor 1941): AAS 33 (1941) 195-205; Radiomesazhë krishtëlindjeje (24 dhjetor 1941): AAS 34 (1942) 10-21; Radiomesazhë krishtëlindjeje (24 dhjetor 1943): AAS 36 (1944) 11-24; Radiomesazhë krishtëlindjeje (24 dhjetor 1944): AAS 37 (1945) 10-23; Fjalim Kardinalëve (24 dhjetor 1945): AAS 38 (1946) 15-25; Fjalim Kardinalëve (24 dhjetor 1946): AAS 39 (1947) 7-17; Radiomesazhë krishtëlindjeje (24 dhjetor 1947): AAS 40 (1948) 8-16; Gjon PP. XXIII, Let. Enc. *Mater et Magistra*: AAS 53 (1961) 401-464; Let. Enc. *Pacem in terris*: AAS 55 (1963) 257-304; Pali PP. VI, Lett. Enc. *Ecclesiam Suam*: AAS 56 (1964) 609-659; Fjalim Asemblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara (4 tetor 1965): AAS 57 (1965) 877-885; Let. Enc. *Populorum Progressio*: AAS 59 (1967) 257-299; Fjalim «Campesinos (Fshatarëve)» kolumbian (23 gusht 1968) AAS 60 (1968) 619-623; Fjalim Asemblesë së Përgjithshme Latino-Amerikane (24 gusht 1968): AAS 60 (1968) 639-649; Fjalim Konferencës FAO (16 nëntor 1976): AAS 62 (1970) 830-838; Let. Apost. *Octogesima Adveniens*: AAS 63 (1971) 401-441; Fjalim Kardinalëve, (23 qershor 1976): AAS 64 (1972) 496-505; Gjon Pali PP. II, Fjalim Konferencës së tretë të Përgjithshme të episkopatës Latino-Amerikane (28 janar 1979): AAS 71 (1979) 187 vv.; Fjalim Indios në Cuilapan (29 janar 1979): l. c., 207 vv.; Fjalim punëtorëve të Guadalajara (30 janar 1979): l. c., 221 vv. Fjalim punëtorëve të Monterrey (31 janar 1979): l. c., 240 vv.; Konc. Ekum. Vat. II, Deklaratë mbi lirinë fetare *Dignitatis Humanae*: AAS 58 (1966) 929-941; Kusht. Bar. mbi Kishën në botën bashkëkohore *Gaudium et spes*: AAS 58 (1966) 1025-1115; Dokumentat *Synodi Episcoporum. De iustitia in mundo*: AAS 63 (1971) 923-941.
- <sup>104</sup> Krh. Gjon PP. XXIII, Let. Enc. *Pacem in terris*: AAS 55 (1963) 289 vv.; Pali PP. VI, Let. Enc. *Populorum Progressio*: AAS 59 (1967) 257-299.
- <sup>105</sup> Krh. *Lk* 16, 19-31.
- <sup>106</sup> Krh. Gjon Pali PP. II, Homelia në Sh. Domingo (25 janar 1979), n. 3: AAS 71 (1979) 157vv.; Fjalim drejtuar Indios-ve dhe «Campesinos-ve» në Oaxaca (30 janar 1979), n. 2: l. c., 207 vv.; Fjalim Punëtorëve të Monterrey (31 janar 1979), n. 4: l. c. 242.
- <sup>107</sup> Krh. Pali PP. VI, Ep. Ap. *Octogesima Adveniens*, 42: AAS 63 (1971) 431.
- <sup>108</sup> Krh. *Mt* 25, 31-46.
- <sup>109</sup> *Mt* 25, 42.43.
- <sup>110</sup> *2 Tm* 4, 2.
- <sup>111</sup> Krh. Piu PP. XI, Let. Enc. *Quadragesimo Anno*: AAS 23 (1931) 213; Let. Enc. *Non abbiamo bisogno*: AAS 23 (1931) 285-312; Let. Enc. *Divini Redemptoris*: AAS 29 (1937); 65-106; Epist. Enc. *Mit brennender Sorge*: AAS 29 (1937) 145-167; Piu PP. XII, Let. Enc. *Summi Pontificatus*: AAS 31 (1939) 413-453.
- <sup>112</sup> Krh. *2 Kor* 3, 6.
- <sup>113</sup> Kusht. bar. mbi Kishën në botën bashkëkohore *Gaudium et spes*, 31: AAS 58 (1966) 1050.
- <sup>114</sup> Krh. AAS 58 (1966) 929-946.
- <sup>115</sup> Kusht. bar. mbi Kishën në botën bashkëkohore *Gaudium et spes*, 22: AAS 58 (1966) 1042
- <sup>116</sup> Krh. *1 Kor* 6, 15; 11, 3; 12, 12 v., *Ef* 1, 22 v., 2, 15 v.; 4, 4 v.; 5, 30; *Kol* 1, 18; 3, 15; *Rm* 12, 4 v.; *Gal* 3, 28.
- <sup>117</sup> Krh. *2 Pt* 1, 4.
- <sup>118</sup> Krh. *Ef* 2, 10; *Gjn* 1, 14.16.
- <sup>119</sup> *Gjn* 1, 12.
- <sup>120</sup> Krh. *Gjn* 4, 14.
- <sup>121</sup> *Gal* 4, 4.
- <sup>122</sup> *Gjn* 11, 25 v.
- <sup>123</sup> Prefacioni për të vdekur I.
- <sup>124</sup> *Gjn* 6, 63.
- <sup>125</sup> *Konfes.*, I, 1: CSEL 33, p. 1.
- <sup>126</sup> *Mt* 12, 30.
- <sup>127</sup> Krh. *Gjn* 1, 12.
- <sup>128</sup> *Gal* 4, 5.
- <sup>129</sup> *Gal* 4, 6; *Rm* 8, 15.
- <sup>130</sup> Krh. *Rm* 15, 13; *1 Kor* 1, 24.
- <sup>131</sup> Krh. *Is* 11, 2 v.; *Vap* 2, 38.
- <sup>132</sup> Krh. *Gal* 5, 22 v.
- <sup>133</sup> Ndjekësorja e Rrëshajëve.
- <sup>134</sup> krh. Konc. Ekum. Vat. II, Kusht. dogm. mbi Kishën *Lumen gentium*, 16: AAS 57 (1965) 20.
- <sup>135</sup> *Ibid.*, 1: l. c., 5.
- <sup>136</sup> Krh. *Rm* 8, 15; *Gal* 4, 6.
- <sup>137</sup> Krh. *Rm* 8, 15.
- <sup>138</sup> Krh. *Rm* 8, 30.
- <sup>139</sup> *Mt* 20, 28.
- <sup>140</sup> Konc. Ekum. Vat. II, Kusht. dogm. mbi Kishën *Lumen gentium*, 31-36: AAS 57 (1965) 37-42.
- <sup>141</sup> *Gjn* 14, 24.
- <sup>142</sup> *Gjn* 1, 18.
- <sup>143</sup> Krh. Konc. Ekum. Vat. II, Kusht. dogm. mbi Zbulesën Hyjnore *Dei Verbum*, 5, 10, 21: AAS 58 (1966) 819; 822; 827 v.

- <sup>144</sup> Krh. Konc. Ekum. Vat. I, Kusht. dogm. mbi fenë katolike *Dei Filius*, kap. 3: *Conciliorum Oecumenicorum Decreta*, Ed. Instituti për Shkencat Fetare, Bologna 1973, 807.
- <sup>145</sup> Konc. Ekum. Vat. I, Kusht. dogm. I mbi Kishën e Krishtit *Pastor Aeternus*: ed. cit., 811-816; Konc. Ekum. Vat. II, Kusht. dogm. mbi Kishën *Lumen gentium*, 25: AAS 57 (1965) 30 v.
- <sup>146</sup> Krh. *Mt* 28, 19.
- <sup>147</sup> Krh. Konc. Ekum. Vat. I, Kusht. dogm. I mbi Kishën e Krishtit *Pastor Aeternus*: ed. cit., 811-816.
- <sup>148</sup> Krh. Kusht. dogm. mbi Kishën *Lumen gentium*, 18-27: AAS 57 (1965) 21-33.
- <sup>149</sup> Krh. *ibid.*, 12, 35: *l. c.*, pp. 16 s.; 40 s.
- <sup>150</sup> Krh. S. Agustini, *Sermo* 43, 7-9; PL 38, 257 v.
- <sup>151</sup> Krh. Kusht. bar. mbi Kishën në botën bashkëkohore *Gaudium et spes*, 44.57.59.62: AAS 58 (1966) 1064 v., 1077 vv., 1079 v., 1082 vv.; Dekr. mbi formimin meshtarak *Optatam Totius*, 15 AAS 58 (1966) 722.
- <sup>152</sup> *Gjn* 14, 24.
- <sup>153</sup> *Gjn* 20, 21 v.
- <sup>154</sup> Krh. Konc. Ekum. Vat. II, Kusht. dogm. mbi Liturgjinë e Shenjtë *Sacrosanctum Concilium*, 10; AAS 56 (1964) 102.
- <sup>155</sup> Krh. *Rm* 6, 3 vv.
- <sup>156</sup> *Fil* 2, 8.
- <sup>157</sup> Krh. *Gjn* 5, 26; 1 *Gjn* 5, 11.
- <sup>158</sup> Krh. *Eb* 9, 24; 1 *Gjn* 2, 1.
- <sup>159</sup> 1 *Kor* 6, 20.
- <sup>160</sup> *Gjn* 1, 12.
- <sup>161</sup> Krh. *Rm* 8, 23.
- <sup>162</sup> *Zb* 5, 10; 1 *Pt* 2, 9.
- <sup>163</sup> Krh. *Gjn* 1, 1-4.18; *Mt* 3, 17; 11, 27; 17, 5; *Mk* 1, 11; *Lk* 1, 32.35; 3, 22; *Rm* 1, 4; 2 *Kor* 1, 19; 1 *Gjn* 5, 5.20; 2 *Pt* 1, 17; *Heb* 1, 2.
- <sup>164</sup> Krh. 1 *Gjn* 5, 5-11.
- <sup>165</sup> Krh. *Rm* 5, 10.11; 2 *Kor* 5, 18 s., *Kol* 1, 20.22.
- <sup>166</sup> Konc. Ekum. Vat. II, Kusht. dogm. mbi Kishën *Lumen gentium*, 11: AAS 57 (1965) 15 v.; Pali PP. VI, Fjalim i 15 shtatorit 1965: Mësimi Palit VI, III (1965) 1036.
- <sup>167</sup> Krh. Konc. Ekum. Vat. II, Kusht. dogm. mbi Liturgjinë e Shenjtë *Sacrosanctum Concilium*, 47; AAS 56 (1964) 113.
- <sup>168</sup> Krh. Pali PP. VI, Let. Enc. *Mysterium Fidei*: AAS 57 (1965) 553-574.
- <sup>169</sup> Krh. Konc. Ekum. Vat. II, Kusht. dogm. mbi Liturgjinë e Shenjtë *Sacrosanctum Concilium*, 47; AAS 56 (1964) 113.
- <sup>170</sup> Krh. *Gjn* 6, 52.58, 14, 6; *Gal* 2, 20.
- <sup>171</sup> 1 *Kor* 11, 28.
- <sup>172</sup> *Mk* 1, 15.
- <sup>173</sup> *Ibid.*
- <sup>174</sup> Krh. 1 *Pt* 2, 5.
- <sup>175</sup> *Ps* 50 (51), 6.
- <sup>176</sup> *Mk* 2, 5.
- <sup>177</sup> *Gjn* 8, 11.
- <sup>178</sup> *Mt* 5, 6.
- <sup>179</sup> Krh. Kongregata e Shenjtë për Doktrinën e Fesë, *Normae pastorales circa absolutionem sacramentalem generali modo impertiendam*: AAS 64 (1972) 510-514; Pali PP. VI, Fjalim një grupit ipeshkëvinsh të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në vizitë «ad limina» (20 prill 1978): AAS 70 (1978) 328-332; Gjon Pali II, Fjalim një grupit ipeshkëvinsh të Kanadasë në vizitë «ad limina» (17 nëntor 1978): AAS 71 (1979) 32-36.
- <sup>180</sup> Krh. AAS 58 (1966) 177-198.
- <sup>181</sup> *Mt* 20, 28.
- <sup>182</sup> Piu PP. XII, Let. Enc. *Mystici Corporis*: AAS 35 (1943) 193-248.
- <sup>183</sup> *Gjn* 1, 43.
- <sup>184</sup> Krh. Konc. Ekum. Vat. II, Kusht. dogm. mbi Kishën *Lumen gentium*, 1: AAS 57 (1965) 5.
- <sup>185</sup> 1 *Kor* 7, 7; krh. 12, 7.27; *Rm* 12, 6; *Ef* 4, 7.
- <sup>186</sup> krh. Konc. Ekum. Vat. II, Kusht. dogm. mbi Kishën *Lumen gentium*, 36: AAS 57 (1965) 41 v.
- <sup>187</sup> *Gal* 5, 1; Krh. *ibid.* 13.
- <sup>188</sup> Krh. *Gjn* 10, 10.
- <sup>189</sup> *Gjn* 16, 13.
- <sup>190</sup> Krh. *Rm* 5, 5.
- <sup>191</sup> Krh. Konc. Ekum. Vat. II, Kusht. dogm. mbi Kishën *Lumen gentium*, 63-64: AAS 57 (1965) 64.
- <sup>192</sup> Krh. kap. VIII, 52-69: AAS 57 (1965) 58-67.
- <sup>193</sup> Fjalim i mbylljes së sezonit të III të Koncilit Ekumenik të Vatikanit II (21 nëntor 1964): AAS 56 (1964) 1015.
- <sup>194</sup> Krh. Konc. Ekum. Vat. II, Kusht. dogm. mbi Kishën *Lumen gentium*, 56: AAS 57 (1965) 60.
- <sup>195</sup> *Ibid.*
- <sup>196</sup> *Heb* 2, 10.
- <sup>197</sup> Krh. *Gjn* 19, 26.
- <sup>198</sup> Krh. *Vap* 1, 14; 2.
- <sup>199</sup> Krh. *Gjn* 19, 27.
- <sup>200</sup> *Gjn* 3, 16.
- <sup>201</sup> *Gjn* 15, 5.
- <sup>202</sup> Krh. *Vap* 1, 14.
- <sup>203</sup> Krh. *Vap* 1, 13.
- <sup>204</sup> Krh. *Vap* 1, 8.
- <sup>205</sup> *Ibid.*